

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6158
E premte, 6 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Kosova shënon rekord të rasteve të reja me Covid



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT DHE REXHEP SELIMIT U ËSHTË KONFIRMUAR AKTAKUZA NGA GJYKATA SPECIALE

HERONJTË E LUFTËS DHE TË PAQES DËRGOHEN NË HAGË



Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi të enjten kanë udhëtuar për në Hagë, pas konfirmimit të aktakuzave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Para nisjes ata kanë shprehur krenari për të



kaluarën e tyre, duke u zotuar se do të kthehen faqebardhë. Ish-udhëheqësi i Drejtorisë Politike i UÇK-së, Hashim Thaçi, ka dhënë dorëheqje nga detyra e presidentit të Kosovës, duke ftuar qytetarët dhe partitë politike për



bashkim. Edhe Veseli dhe Selimi kanë dhënë dorëheqje nga pozita publike. Liderët institucionalë dhe politikë në Kosovë e në Shqipëri kanë vlerësuar lart sjelljen e ish-eporëve të lartë të UÇK-së

Osmani: Kosova ka nevojë për unitet dhe solidaritet

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



HOTI DHE SEKRETARI I VATIKANIT BISEDOJNË PËR THELLIM TË BASHKËPUNIMIT F. 6

KATËR VJET PA ASTRIT DEHARIN F. 6

KËRKOHEM PARABURGIM NDAJ PESË PERSONAVE PËR "VRASJE TË RËNDË NË TENTATIVË" F. 7

EKONOMI



MINISTRI KRASNIOQI: EKONOMIA DIGJITALE HAP MUNDËSI TË SHUMTA ZHVILLIMORE F. 9

LANSOHET PULLAT POSTARE "BUKURITË NATYRORE TË KOSOVËS" F. 8

ATK-ja APROVON MBI NJË MIJË KËRKESA PËR RIMBURSIM TË TVSH-së, TAP-it DHE TAK-it F. 8

SPORT

BALLKANI NË SHITESË SHPËTON NGA HUMBJA, LLAPI ZHYTET NË KRIZË F. 16

Vazhdon numërimi i votave, rritet epërsia e Bidenit

UASHINGTON, 5 NËNTOR - Amerikanët janë duke pritur nëse numërimi i votave në disa shtete do ta bëjë të qartë fituesin e zgjedhjeve presidenciale, një ditë pasi fitoret në dy shtete vendimtare i rritën shanset për ish-nënpresidentin Joe Biden dhe fushata e presidentit Donald Trump ka ndërmarrë një sërë sfidash ligjore.

Organizatrat e mediave amerikane ende nuk kanë nxjerrë parashikimet për fituesin në gjashtë shtete: Alaska, Arizona, Xhorxha, Nevada, Karolina e Veriut dhe Pensilvania. Sipas



parashikimeve të tyre nga e mërkura, Bideni është fitues në Miçigan dhe Uiskonsin, dy shtete ku Trumpi kishte fituar

në zgjedhjet e vitit 2016. “Nuk po dal për të deklaruar se kemi fituar, por për të thënë se kur të përfundojë numërimi,

ne besojmë se do të jemi fituesit”, ka thënë Bideni. Ai mund ta arrijë pragun e 270 votave në Kolegjin Zgjedhor, i nevojshëm për t'i fituar zgjedhjet nëse ruan epërsinë në Arizona dhe Nevada. Sipas sistemit të Kolegjit Zgjedhor, fituesi i votës popullore në secilin shtet - me përjashtim të Meinit dhe Nebraskës, merr të gjitha votat elektorale të shtetit. Shtetet nuk e deklarojnë zyrtarisht fituesin para se të numërohen të gjitha votat, por organizatat e mediave parashikojnë fituesin kur ata arrijnë në përfundim se nuk kanë mbetur aq vota të

panumëruara sa të ndryshojnë rezultatin, shkruan “VOA”. Gjithashtu, Bideni është duke kryesuar sa i takon votës popullore në shkallë kombëtare. Deri të enjten në mëngjes ai kishte siguruar 71.6 milionë vota, krahasuar me 68.1 milionë vota të hedhura për Trumpin, sipas “Edison Research” dhe “Associated Press”. Me një numër të lartë votuesish të hershëm, numri i përgjithshëm i votuesve për vitin 2020, sipas disa vlerësimeve, mund të arrijë në 150 milionë ose më shumë, një shifër rekord.

Protesta në disa qytete amerikane

UASHINGTON, 5 NËNTOR - Protestuesit kanë dalë në rrugë në disa qytete amerikane të mërkurën, duke bërë thirrje për një numërim të plotë të votave, ndërsa grupe më të vogla mbështetëse të presidentit Trump janë mbledhur para qendrave të numërimit të votave në Miçigan dhe në Arizona. Policia në Nju-Jork ka arrestuar dhjetëra njerëz të mërkurën mbrëma pas asaj që kishte qenë një demonstratë paqësore. Zyrtarët kanë thënë se një grup i vogël njerëzish “u përpoqën ta rrëmbenin” protestën, duke ua vënë zjarrin plehrave dhe duke u përleshur me oficerët e policisë. Protestuesit kanë marshuar edhe në Çikago, Los Anxhelos, Seattle, Hjuston,

Pittsburgh, Minneapolis dhe San Diego. Përveç thirrjes për numërimin e votave, demonstruesit kanë theksuar pabarazinë racore, subjekt i protestave të shumta gjithandej Shteteve të Bashkuara këtë vit. Në shtetin veriperëndimor të Oregonit, guvernatorja Kate Brown ka aktivizuar Gardën Kombëtare, ndërsa policia në Portland i ka cilësuar si trazira protestat e atjeshme duke kryer edhe arrestime. Mbështetësit e presidentit Donald Trump kanë shkruar në një qendër të numërimit të votave në Detroit, Miçigan, për ta kërkuar ndërprerjen e numërimit. Ata në një tubim të mëvonshëm në Phoenix të Arizonaa kanë brohoritur “Ndalni vjedhjen”.



Demonstratat e ndryshme kanë shpërthyer, ndërsa rezultati i zgjedhjeve të së

martës ka mbetur i paqartë dhe presidenti Trump ka bërë pretendime të pambështetura

për mashtrim, ndërsa republikanët kanë ngritur padi të shumta zgjedhore.

Macroni: Franca lufton separatizmin islamik, jo islamin

Paris, 5 nëntor - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se vendi i tij është duke e luftuar “separatizmin islamik, kurrë islamin”. “Franca po lufton kundër... urrejtjes dhe vdekjes që kërcënon fëmijët e saj - kurrë kundër islamit. Ne kundërshtojmë mashtrimin, fanatizmin, ekstremizmin e dhunshëm. Jo fenë”, ka thënë Macron.

Macroni i ka bërë këto komente duke iu përgjigjur një artikulli të “Financial Times”, për të cilin ai ka pretenduar se e citoi gabimisht. Artikulli është hequr nga faja e internetit e gazetës. Në një letër për redaktorin e

gazetës, Macroni ka thënë se gazeta britanike e kishte akuzuar atë për “stigmatizimin e myslimanëve francezë për qëllime elektorale dhe për nxitjen e një klime frike dhe dyshimi ndaj tyre”. “Unë nuk do të lejoj askënd të pretendojë se Franca, ose qeveria e saj, po nxit racizëm kundër myslimanëve”, ka thënë ai.

Në një artikull shkruar nga një korrespondent i “Financial Times”, botuar të martën, pretendohet se deklarata e Macronit ndaj “separatizmit



islamik” rrezikonte të nxisë një “mjedis armiqësor” për myslimanët francezë. Artikulli më vonë është hequr nga faja e internetit e gazetës dhe është zëvendësuar me një njoftim që thoshte se ai kishte “gabime faktike”, raporton “AFP”.

Muajin e kaluar, në Francë, një mësues i historisë u vra në mënyrë mizore, pasi ai e kishte ilustruar një ligjëratë për shprehjen e lirë, me karikaturën e profetit Muhamed. Një 18-vjeçar me origjinë nga Çeçenia, i lindur në Moskë, është përgjegjës për vrasjen. Sulmuesi ia kishte prerë kokën mësuesit. Pas sulmit, ai është qëlluar për vdekje nga policia. Prokurori kundër-terrorizmit, Jean-Francois Ricard, dha këtë njoftim, një ditë pas incidentit, të cilin, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, e quajti

“sulm terrorist islamik”. Presidenti i Francës, Macron, është zotuar se Franca nuk do të heqë dorë nga “vlerat” dhe, gjithashtu, u ka bërë thirrje njerëzve të të gjitha feve, të mos “dorëzohen në frymën e përçarjes”. Javën e kaluar një burrë tjetër vrau tre persona në një kishë të Nicës, në atë që presidenti francez Emmanuel Macron e ka përshkruar si “një sulm terrorist islamik”. Pas protestave dhe bojkotit të mallrave franceze në të gjithë botën, Macroni i ka thënë rrjetit “Al-Jazeera” gjatë fundjavës se ai e kuptonte që karikaturat mund të ishin tronditëse për disa.

Vjosa Osmani, ushtruese e detyrës e presidentit të Kosovës

Osmani: Kosova ka nevojë për unitet dhe solidaritet



Pas dorëheqjes të Hashim Thaçit nga detyra e presidentit, për shkak të aktakuzës nga Gjykata Speciale, Vjosa Osmani do ta ushtrojë edhe funksionin e presidentes krahas kryetares së Kuvendit të Kosovës. Pas marrjes së kësaj detyre, Osmani ka thënë se Kosova ka nevojë për unitet dhe për solidaritet. Ajo ka thënë se do të angazhohet për avancimin e këtyre dy vlerave. Osmani ka thënë se beteja për shtetndërtim është beteja më e vështirë politike. “Prandaj urtia dhe mençuria janë tiparet që e karakterizojnë shtetin tonë. Kjo kohë kërkon lidhshmëri të fuqishme dhe përgjegjësi të përbashkët shtetërore”, ka thënë Osmani

të Kosovës. “Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, vendi ynë po kalon ditë të vështira. Qytetarët e Kosovës duhet të dëshmojnë unitet dhe besnikëri ndaj projektit tonë të përbashkët, republikës sonë. Vendi ynë ka kaluar sfida të shumta gjatë historisë përfshirë edhe luftën e fundit. Qytetarët e Kosovës duhet të dëshmojnë unitet e besnikëri ndaj projektit tonë të përbashkët, republikës sonë. Vendi ynë kaluar sfida të shumta gjatë historisë, përfshirë edhe luftën e fundit, prandaj duhet t’i ushtrojmë me maturi përgjegjësitë institucionale e ta forcojmë qëndrueshmërinë e shtetit, sepse shteti bëhet i fortë edhe kur përballet me sfida, duke i tejkaluar dinjitetshëm”, ka thënë ajo.

Osmani ka theksuar se proceset që do të vijnë nuk do ta dëmtojnë projektin kombëtar për liri. “Ne jemi të vetëdijshëm se veprimet e Dhomave të Specializuara janë rrjedhojë e obligimeve shtetërore të cilat Kosova i ka pranuar. Proceset që vijnë pas nuk do ta dëmtojnë projektin tonë kombëtar për liri, i cili është ndërtuar me sakrificën e brezave të tërë dhe gjakun e derdhur të ushtarëve të

ushtrisë sonë çlirimtare”, ka deklaruar Osmani, duke vlerësuar lart veprimet e ish-drejtuësve të UÇK-së, pa përmendur emra të përveçëm. “Unë dua t’u shpreh vlerësimin tim të gjithë atyre që kanë treguar vendosmëri dhe besim në institucione dhe i janë përgjigjur ftesës së Dhomave të Specializuara, duke dëshmuar kështu besim të palëkundur në drejtësi”, është shprehur Osmani. Më tutje, ajo ka thënë se beteja për shtetndërtim është beteja më e vështirë politike. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se kërkohet urti dhe mençuri. “Prandaj urtia dhe mençuria janë tiparet që e karakterizojnë shtetin tonë. Kjo kohë kërkon lidhshmëri të fuqishme dhe përgjegjësi të përbashkët shtetërore. Sot kur vendi ynë përballet edhe me pandeminë, ne kemi nevojë për solidaritet dhe mirëkuptim të plotë me njëri-tjetrin. Si ushtruese e detyrës e presidentit do të përkushtohem që funksionin ta ushtroj duke i promovuar pikërisht këto vlera. Gjatë këtij rrugëtimi, sikurse deri më tash, do të angazhohem çdo ditë që Kosova të bëhet shtet, ku ëndrrat e qytetarëve tanë jetësohen, ku krijohen

mundësi të barabarta për të gjithë, në të gjitha sferat. Do të sigurohem që zëri im t’i bashkohet zërit të qytetarëve e të jehojë më fort se kurrë”, ka thënë Osmani, duke kërkuar nga qytetarët që të qëndrojnë të bashkuar. “Dua t’ju lus që si qytetarë të këtij vendi, të përkushtuar ndaj vlerave demokratike, të qëndrojmë fort afër njëri-tjetrit për të dëshmuar se kuptojmë dhe i ndajmë këto vlera me njëri-tjetrin”, ka theksuar Osmani, duke shtuar se nuk do të heqin dorë nga kultivimi i vlerave demokratike. “Unë jam e bindur se si vend dhe të gjithë së bashku do të qëndrojmë fort. Angazhimi ynë për shtet ligjor na ka përballur me sfida të rënda, por ne nuk kemi hequr dorë nga përkushtimi për konsolidim të shtetit dhe për kultivim të vlerave demokratike. Pavarësisht prej sfidave, ne kemi qëndruar fort në besimin në vendin tonë, të cilin ju thërras ta dëshmojmë edhe në këto çaste të vështira. E kemi ruajtur këtë shpresë dhe besim edhe kur kemi qenë viktimë ndaj një agresioni të rëndë. Serbia ka vrarë mbi 13 mijë njerëz në Kosovë. 1 133 ish-in fëmijë”, ka thënë Osmani, dhe ka shtuar se Serbia është shtet gjenocidar.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, pas dorëheqjes të presidentit Hashim Thaçi, pas aktakuzës së Gjykatës Speciale, do ta ushtrojë edhe funksionin e presidentes së vendit. Këtë detyrë ajo e ka pranuar nga stafi i ish-presidentit Hashim Thaçi. “Vjosa Osmani zyrtarisht merr funksionin e u. d. të presidentes së Kosovës. Në përputhje me obligimet kushtetuese, pas dorëheqjes

së presidentit të vendit, z. Hashim Thaçi, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, dr. Vjosa Osmani, sot ka marrë zyrtarisht funksionin e u. d. të presidentes së Kosovës. Ceremonia e pranidorezimit është bërë në prezencën e stafit të Presidencës dhe kryetares së Kuvendit të Kosovës”, ka njoftuar Presidenca e Kosovës. Pas pranimit të kësaj detyre, Osmani në një konferencë për media ka thënë se si presidente në detyrë do të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve



HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT DHE REXHEP SELIMIT U ËSHTË KONFIRMUAR AKTAKUZA NGA GJYKATA SPECIALE

HERONJTË E LUFTËS DHE TË PAQES DËRGOHEN NË HAGË

Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi të enjten kanë udhëtuar për në Hagë, pas konfirmimit të aktakuzave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Para nisjes ata kanë shprehur krenari për të kaluarën e tyre, duke u zotuar se do të kthehen faqebardhë. Ish-udhëheqësi i Drejtorisë Politike të UÇK-së, Hashim Thaçi, ka dhënë dorëheqje nga detyra e presidentit të Kosovës, duke ftuar qytetarët dhe partitë politike për bashkim. Edhe Veseli dhe Selimi kanë dhënë dorëheqje nga pozita publike. Liderët institucionalë dhe politikë në Kosovë e në Shqipëri kanë vlerësuar lart sjelljen e ish-eporëve të lartë të UÇK-së

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar të enjten ua ka konfirmuar aktakuzën Hashim Thaçit, ish-president të Kosovës dhe Kadri Veselit, ish-kryetarit të PDK-së. Pas konfirmimit të aktakuzave, dy ish-themeluesit e UÇK-së vullnetarisht janë nisur për në Hagë, duke shprehur bindjen që së bashku me ish-bashkëluftëtarët e tyre do të kthehen faqebardhë.

Në një konferencë për media, para nisjes për në Hagë, Hashim Thaçi ka thënë se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe askush nuk mund ta ndryshojë historinë. "Vetëm toleranca, respekti dhe bashkëjetesa janë ato që çojnë vendin përpara. Jemi lridashës

dhe jo popull hakmarrës, prandaj asnjë pretendim s'mund të ndryshojë apo ta shkruajë historinë. Kosova ka qenë viktima, e Serbia agresorja. Kjo situatë e re është mundësi e re për Kosovën dhe duhet ta shënojmë në avantazh për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës dhe kjo arrihet duke ruajtur unitetin me qytetarët dhe bashkësinë ndërkombëtare", ka

thënë Thaçi.

Ai ka shprehur krenari që për tri dekada iu ka shërbyer qytetarëve të Kosovës. "Në këto rrethana të reja ftoj forcat politike të dëshmojnë maturi, të qëndrojmë të bashkuar e të mos lejojmë të thellohemi në krizë kushtetuese apo institucionale, ta vëmë interesin e shtetit mbi ato personale. Vendi ynë s'ka kohë të humbë, prandaj ju ftoj ta ruajmë

orientimin atlantik të shtetit dhe të shoqërisë. Ju ftoj të besoni në shtetin e Kosovës dhe Kosovën e re e evropiane, në atë të rendit dhe ligjit, në Kosovën në NATO dhe raporte special e të përhershme me ShBA-në", ka thënë ai, duke shtuar se asnjë sfidë nuk do të mund ta cenojë partneritetin e Kosovës me aleatët perëndimorë. "Të dashur qytetarë, ju falënderoj për solidaritetin dhe mbështetjen në këtë periudhë kohore, por ju ftoj që ta ruani qetësinë dhe të shmangni çdo lloj manifestimi publik, mbështetës apo protestues. Drejtësia nuk bëhet në rrugë, por me ballafaqim të argumenteve. Ju falënderoj për besimin sepse kjo nuk është lamtumirë, por vetë mirupafshim. Do të shihemi prapë e do të dalim faqebardhë.

Ky është premtimi im për ju. Zoti e bekoftë Kosovën!", ka thënë Thaçi.

Pas konfirmimit të aktakuzës, edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka bërë me dije se do të tërhiqet nga të gjitha pozitat politike. "E vlerësoj faktin që Dhomat e Specializuara kanë treguar mirësjellje duke më nisur një ftesë për t'u paraqitur në gjykatë në vend se të më arrestonin në mënyrë të padinjitetshme. Unë i jam përgjigjur këtij akti mirësjelljeje, duke u pajtuar që të udhëtoj këtë mëngjes për në Hagë me përfaqësues të Tribunalit, ku formalisht do të paraqitem para trupit gjykues për t'iu përgjigjur akuzave të bëra dhe për të nisur një proces të gjatë të mbrojtjes", ka thënë Veseli, sipas një njoftimi të lëshuar për media nga PDK-ja.

Ai ka kërkuar që ky qëndrim i tij të respektohet nga të gjithë në Kosovë. "Kjo gjë do të kërkojë angazhimin dhe përqendrimin tim të plotë, prandaj kam vendosur të tërhiqem nga të gjitha aktivitetet publike dhe politike për sa kohë zgjat ky proces. Nuk do të bëj deklarata të tjera publike apo paraqitje zyrtare në Kosovë sa procesi gjyqësor vazhdon. Të paktën për

OVLUÇK paralajmëron protestë

Ushtruesi i detyrës i kreut të OVL UÇK-së, Faton Klinaku, ka njoftuar së Këshilli Drejtues i kësaj organizate ka vendosur për organizimin e një proteste. Në një konferencë për media, ai ka deklaruar se për datën se kur do të

mbahet protesta pritet të vendoset në ditët në vijim. Ai ka thënë se protesta do të jetë paqësore duke respektuar rekomandimet e IKShPK-së. "Kryesia e diskutoi këtë situatë. Kemi pasur takime me deputetët

e Kuvendit të Kosovës. Vendosëm të organizojmë protestë. Për datën ju informojmë me kohë, por mund të konfirmoj që edhe nesër e kemi mbledhjen e Këshillit Drejtues, ku do të diskutohet për protestën", ka deklaruar Klinaku.

momentin, jam një qytetar privat. Deri në fund të këtij procesi kërkoj që ky qëndrim i imi të respektohet nga të gjithë në Kosovë, veçanërisht nga ata të cilët janë të angazhuar në media apo në jetën publike dhe politike”, ka thënë Veseli.

Bashkë me Thaçin dhe Veselin për në Hagë ka udhëtuar edhe Rexhep Selimi, gjithashtu një nga themeluesit e UÇK-së, ish-shef i grupit parlamentar i LV-së, të cilit një ditë më parë i është konfirmuar aktakuza nga Specialja. Ai ka thënë se do të shkojë në Hagë kokëllartë. “Unë po shkoj me kokën lart dhe kurdo që kthehem do të kthehem me kokën lart sepse isha, jam dhe do të jem ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të cilën jam i gatshëm të jap gjithçka nga vetja. Ideali i asaj ushtrie të lavdishme është mbi mua, mbi këdo, mbi gjithçka. Mirë u takofshim në fitoren e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!”, ka shkruar Selimi në profilin e vet në “Facebook”.

Një ditë më parë Specialja aktakuzën ia ka konfirmuar edhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi. Ai është arrestuar dhe dërguar në Hagë pas një aksioni të bastisjes në shtëpinë e tij në Prishtinë.

Kosova dhe Shqipëria përkrah çlirimtarëve

Konfirmimi i aktakuzave për Thaçin, Veselin dhe Selimin ka nxitur reagime të shumta në Kosovë dhe në Shqipëri. Liderë politikë dhe bashkëlufetarë të tyre kanë dalë në krahë të ish-udhëheqësve të UÇK-së, duke besuar fuqishëm në pafajësinë e tyre. “Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte faktor uniteti në vitet e krenarisë dhe të sakrificës. Sot, të gjithë ne si popull, por edhe si liderë politikë, duhet të tregojmë unitetin kombëtar, në rrethanat e reja të krijuara. Presidenti Thaçi, kryetari Veseli dhe të gjithë bashkëlufetarët e mi që po përballen me gjyqësinë

Thaçi jep dorëheqje nga detyra e presidentit

Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga detyra e presidentit pasi ndaj tij është konfirmuar aktakuza nga Gjykata Speciale. Ai ka deklaruar se nuk dëshiron të shkojë para Dhomave të Specializuara si president i Kosovës. “Ashtu, siç kam premtuar, nuk do të lejoj në asnjë rrethanë që para gjyqit të dal presidenti i Republikës së Kosovës. Prandaj, për ta

mbrojtur integritetin e Presidencës së Republikës së Kosovës, integritetin e shtetit të Kosovës, integritetin dhe dinjitetin e qytetarit të Kosovës, popullit të Kosovës, duke respektuar edhe partneritetin edhe me bashkësinë ndërkombëtare, unë sot jap dorëheqje nga pozita e presidentit të Republikës së Kosovës”, ka deklaruar Thaçi.



AAK-ja kërkon ndërprerjen e dialogut me Serbinë

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), parti kjo që është pjesë e koalicionit qeveritar, ka kërkuar që qeveria t'i ndërpresë menjëherë të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin e dialogut me Serbinë. Në një komunikatë, pas mbledhjes së kryesisë së AAK-së, ka vlerësuar se duhet të thirret mbledhje urgjente e Këshillit të Sigurisë së Kosovës për situatën e sigurisë së përgjithshme si dhe seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, për përkrahje të vlerave të UÇK-së dhe të luftëtarëve të lirisë. “AAK-ja kërkon: Mbledhje të jashtëzakonshme të qeverisë për gjendjen e krijuar pas ngritjes së aktakuzave nga Dhomat e Specializuara. Qeveria duhet t'i ndërpresë menjëherë të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin e dialogut me Serbinë deri në një situatë të re”, është thënë në

deklaratën për media të AAK-së pas mbledhjes së kryesisë së kësaj partie. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e Kryesisë, ku ka bërë me dije se është duke i ndjekur me vëmendje zhvillimet e fundit lidhur me Gjykatën Speciale. “Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se vendi po kalon në një situatë të vështirë institucionale, e cila, përveçse duhet të përballohet me qetësi dhe maturi, kërkon edhe unifikim e vendime të përgjegjshme politike dhe institucionale. Lidhja Demokratike e Kosovës beson thellë se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e pastër dhe është zhvilluar vetëm si mjet i fundit për ta ndaluar dhunën sistematike, represionin dhe gjenocidin e shtetit serb në Kosovë”, është thënë në deklaratën e LDK-së.

ndërkombëtare, duhet të kenë përkrahjen tonë dhe të qeverisë së Kosovës, pa asnjë rezervë. Duke besuar fuqishëm se do të vërtetohet pafajësia e tyre, Republika e Kosovës do ta tejkalojë faqebardhë edhe këtë sfidë”, ka shkruar ish-kryeministri Ramush Haradinaj në profilin e vet në “Facebook”. Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, beson se Thaçi dhe Veseli do të dalin faqebardhë nga ky proces. “Që nga përfundimi i luftës disa herë është kërkuar që udhëheqës dhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të ballafaqohen me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare dhe ato në Kosovë që drejtoreshin nga prokurorë dhe gjyqtarë ndërkombëtarë dhe asnjëherë nuk ka ndodhur që dikush të përpiqet t'i shmanget drejtësisë. Përkundër vuajtjeve individuale dhe familjare që kanë ngrëthyer

në vetvete këto procese, unë kam besimin e plotë se bashkëlufetarit im, presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe të gjithë të akuzuarit e tjerë, luftën e UÇK-së do ta mbrojnë në mënyrë dinjitoze dhe në fund do të dalin faqebardhë nga ky proces”, ka thënë Limaj. Në pafajësinë e Thaçit, Veselit dhe ish-luftëtarëve të tjerë të UÇK-së besojnë edhe liderët institucionalë të Shqipërisë. “Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë dhe heroike. Vlerësoj aktin e dorëheqjes së presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, për t'u ballafaquar me akuzat dhe besoj në pafajësinë e tij e të gjithë bashkëlufetarëve, sikundër është konfirmuar edhe në të kaluarën. Ky është një moment reflektimi për ta forcuar më shumë bashkëpunimin dhe bashkimin për interesin më të mirë kombëtar”, ka shkruar

presidenti shqiptar Ilir Meta në llogarinë e vet në “Facebook”.

Kurse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vlerësuar se ky është një proces absurd që nuk e cenon luftën e UÇK-së. “Hashim Thaçi ka gjithë mbështetjen dhe solidaritetin e Shqipërisë në këtë betejë të radhës për Kosovën dhe për drejtësinë e pacenueshme të luftës çlirimtare. Procesi absurd ndaj tij do ta vulosë përfundimisht pastërtinë e UÇK-së dhe pamundësinë për ta rishkruar historinë e saj”, ka shkruar Rama në llogarinë e vet në “Twitter”.

Zyra e Prokurorit të Specializuar më 24 qershor kishte njoftuar se më 24 prill ua ka dërguar Dhomave të Specializuara të Kosovës një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të tjerë akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte. Sipas Zyrës së Prokurorit, ata janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme. Krimet e paraqitura në aktakuzë përfshijnë “qindra viktime të identifikuara shqiptare, serbë dhe romë të Kosovës dhe kundërshtarë politikë”. Ende nuk është e qartë se kush bën pjesë në grupin e “të tjerëve”, siç i ka cilësuar Zyra e Prokurorit.

LV-ja shpreson në pafajësinë e Thaçit dhe Veselit, kërkon zgjedhje të reja

Partia më e madhe në vend, Lëvizja Vetëvendosje, e ka quajtur dorëheqjen e presidentit Hashim Thaçi veprim të duhur, por të vonuar. Përmes një reagimi, kjo parti ka vlerësuar se Thaçi është dashur të vepronte kështu më herët. “E vlerësojmë gjestin e dorëheqjes prej presidencës të Hashim Thaçit si të duhur, por të vonuar. Do të ishte mirë të vepronte qysh kur erdhi lajmi për akuzat, e jo të linte vend për të menduar se në prapaskenë po negocion për ta shpëtuar veten prej atyre akuzave. Dhjetë vjetët e fundit janë dëshmi se si kushdo që ka pretenduar ta mbrojtë UÇK-në përmes pazareve të fshehta, ka dështuar, dhe vetëm sa e ka rritur dëmin. Vetë Gjykata Speciale është padrejtësi e prodhuar prej tyre, përderisa ne si Lëvizje, bashkë me shumë veteranë e qytetarë, protestuam kundër saj”, është thënë në njoftimin e LV-së, duke i përmendur zgjedhjet e lira. “Kosovës i duhen zgjedhje të reja e të lira, prej të cilave do të dalë një qeveri e cila gëzon mbështetje dhe legjitimitet prej shumicës së qytetarëve, qeveri që ia kthen besueshmërinë vendore e ndërkombëtare Kosovës. Presidenti i ri nuk mund të dalë prej pazareve në Kuvendin e vjetër e të deformuar”, ka vlerësuar LV-ja.



Hoti dhe sekretari i Vatikanit bisedojnë për thellim të bashkëpunimit

VATIKAN, 5 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, është prituri në takim nga sekretari i shtetit të Vatikanit, Kardinali Pietro Parolin. Ai ka treguar se me Parolin ka biseduar për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit dhe të komunikimit përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit. "Një takim shumë i frytshëm me sekretarin e Shtetit të Vatikanit, Kardinalin Pietro Parolin. Eminencën e Tij, Kardinalin Parolin, e kam

falënderuar për mbështetjen e Selisë së Shenjtë për popullin e Kosovës, duke kontribuar kështu për paqen e qëndrueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Me sekretarin e Shtetit të Vatikanit, Kardinalin Parolin, biseduam për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit dhe të komunikimit përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit, që do të rezultonte me njohje të vlefshme të sistemit të vlerave të përbashkëta të të dy vendeve", ka njoftuar Hoti.



Zemaj dhe Daka: Zgjedhjet në Podujevë dhe Mitrovicën Veriore duhet të mbahen sipas ligjeve në fuqi



PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka zhvilluar takim me kryetaren e KQZ-së, Valdete Daka, për të biseduar për organizimin e zgjedhjeve që do të mbahen në Podujevë dhe në Mitrovicën Veriore. Me këtë rast, Zemaj ka thënë se zgjedhjet në këto dy komuna duhet të mbahen duke respektuar vendimet dhe ligjet në fuqi. "Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut të 29 nëntorit, për shkak të gjendjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19, duhet të zhvillohen ndryshe nga herët e tjera, duke respektuar vendimet dhe ligjin

në fuqi. Përkritazi për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në kohë pandemie biseduam sot me kryetaren e Komisionit Qendror Zgjedhor, znj. Valdete Daka. Sipas gjendjes aktuale, konsiderojmë të ndalohen të gjitha tubimet publike për fushatën zgjedhore gjatë zgjedhjeve lokale dhe të zbatohen masat parandaluese sipas IKShPK-së dhe MSh-së. Prioriteti ynë është shëndeti i qytetarëve edhe në kohë zgjedhjesh, andaj të gjithë duhet t'i respektojmë masat dhe të mobilizohemi për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19", ka thënë Zemaj.

Katër vjet pa Astrit Deharin

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Në 4-vjetorin e vdekjes së Astritit Deharit, një delegacion i Lëvizjes Vetëvendosje, i prirë nga kryetari i grupit parlamentar i kësaj lëvizje, Rexhep Selimi, bashkë me prindërit dhe familjarët e Astritit, deputetët e tjerë, kanë bërë homazhe te varri i tij. Me këtë rast, kjo lëvizje ka thënë se janë bërë katër vjet prej vrasjes së Astrit Deharit në burgun e Prizrenit, në duar të shtetit e nga vetë shteti. "Drejtësia për Astritin nuk është vënë në vend ende. Vrasja e Astritit filloi qëkur u arrestua me akuza të fabrikuara e të montuara dhe teksa po mbahej padrejtësisht në burg, në duar të një shteti të kapur e të korruptuar, i cili po vazhdon pengimin e zbardhjes së këtij akti. Sikundër kemi bërë deri tani, edhe në këtë katërvjetor të mungesës fizike, Astritin do ta kujtojmë si aktivistin e zellshëm e të



pashembullt, punëtor e fjalëpak, i cili nuk qe asnjëherë i qetë me degradimin e vazhdueshëm që po i bëhej vendit", ka njoftuar

Vetëvendosje. Sipas Vetëvendosjes, Astriti do të duhej të ishte në krye të aktiviteteve si aktivist, e në krye të detyrës si mjek e pranë

familjes si familjar. "E, megjithatë, për secilin aktivist të Lëvizjes Vetëvendosje, e për secilin qytetar që i do drejtësinë dhe barazinë në këtë

vend, Astriti mbetet personifikim i përpjekjes së përditshme që republikës t'ia kthejmë dinjitetin e qytetarëve shpresën. Astriti shihte më larg e më gjerë se të gjithë ne. Herët e kishite kuptuar që fati individual fiton rëndësinë vetëm në një shoqëri të mirëqenë, të lirë, të drejtë, të barabartë e të dinjitetshme. Ashtu siç ishte shembull i përkushtimit për të mirën e përgjithshme, është bërë simbol i gjithmonshëm i përpjekjeve për drejtësi dhe barazi, përherë frymëzues për ne dhe të tjerët që do të vijnë. Ai na ndriçon rrugën përpara me dëshminë e tij, e ne do të ecim palëkundur drejt idealeve të Astritit", ka njoftuar LV-ja. Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se populli shqiptar gjithmonë do ta kujtojë dhe ta nderojë Astrit Deharin dhe asnjëherë nuk do të pushojë së kërkuari drejtësi për të.

RAPORTI 24-ORËSH I IKShPK-SË: GJASHTË TË VDEKUR, 92 TË SHËRUAR DHE 661 RASTE TË REJA ME COVID-19

Kosova shënon rekord të rasteve të reja me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit gjashtë persona në Kosovë e kanë humbur betejën me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se, krahas këtyre vdekjeve, janë paraqitur edhe 661 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 92 persona. “Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 92 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 921 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 5 565”, ka njoftuar IKShPK-ja

është 22 206 raste nga 102 012 persona të dyshimë me virusin SARS-CoV-2 dhe 720 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 92 pacientë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 921 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 565”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të reja me Covid. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 324 raste, komuna Ferizaj 42 raste, komuna Fushë Kosovë 39 raste, komuna Gjilan 37 raste, komuna Gjakovë 35 raste, komuna Podujevë 35 raste, komuna Lipjan 19 raste, komuna Pejë 19 raste, komuna Viti 13 raste, komuna Mitrovicë 11 raste,

komuna Drenas 10 raste, komuna Vushtrri 10 raste, komuna Shtime 9 raste, komuna Skenderaj 8 raste, komuna Deçan 6 raste, komuna Obiliq 6 raste, komuna Kamenicë 5 raste, komuna Kaçanik 5 raste, komuna Suharekë 5 raste, komuna Hani i Elezit 4 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Klokot 3 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe komuna Junik 1 rast”, ka njoftuar IKShPK-ja.

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë gjashtë persona nga Covid-19 si dhe janë paraqitur 661 raste të reja me koronavirus, që shënon numrin më të madh të

rasteve që nga fillimi i pandemisë. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar nga Covidi 92 persona. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 617 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve

në terren, prej të cilëve rezultojnë 661 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjakovë 3, Ferizaj 1, Gjilan 1 dhe Malishevë 1 të cilat i përkasin grupmoshës 50-59 vjeç 1 rast, 60-69 vjeç 2 raste, 70-79 vjeç 1 rast me mbi moshën 80-vjeçare janë 2 raste. Numri total i rasteve pozitive

Zemaj: Rritja e rasteve me Covid -19, shqetësuese

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se rritja e numrit të rasteve të të infektuarve në vend me Covid është shqetësuese. Në llogarinë e vet në “Facebook”, Zemaj ka kërkuar mobilizim të të gjithë mekanizmave shtetërorë për të qenë në krye të detyrës. “Rritja e mëtejme e numrit të rasteve të të infektuarve është shqetësuese. Kërkohe mobilizim i të gjithë mekanizmave shtetërorë për të qenë në krye të detyrës. Përkushtimi duhet të vazhdojë edhe më tej nga secili, ashtu siç kanë punuar dhe po vazhdojnë të punojnë me përkushtim që nga fillimi i pandemisë vullnetarët në qendrën e thirrjeve falas pranë IKShPK-së. Është për çdo respekt puna dhe përkushtimi i këtij ekipi, mjekëve dhe absolventëve të Fakultetit të Mjekësisë. Nuk do të lodhemi nga angazhimi gjatë pandemisë. Edhe më fuqishëm dhe bashkë do të vazhdojmë ta luftojmë virusin vdekjeprurës!”, ka shkruar Zemaj.



Kërkohe paraburgim për pesë persona për ‘vrasje të rëndë në tentativë’

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, caktimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarve G. K., A. K., F. K., B. K., dhe Sh. K., me dyshimin se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Vrasje e rëndë

në tentativë”, nga neni 173, paragrafi 1, pika 1.9, lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Rasti ka të bëjë me përlëshjen e cila ka ndodhur në Fushë-Kosovë më 3 nëntor 2020 që, si pasojë e shqiptimit të një tikete kundërvajtjeje, janë sulmuar fizikisht me mjete të forta (shufra të metalit) dy zyrtarë

policorë nga shtatë persona të dyshuar. Nga kjo përlëshje pesë persona kanë marrë lëndime trupore, prej tyre dy zyrtarë, të cilët kanë pranuar trajtim mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Të dyshuarit, me vendim të Prokurorit të Shtetit, gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh.



ATK-ja aprovon mbi një mijë kërkesa për rimbursim të TVSh-së, TAP-it dhe TAK-it

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se për periudhën janar-tetor numri i kërkesave për rimbursim të TVSh-së, TAP-it dhe TAK-ut ka qenë 1 787. Kjo administratë ka theksuar se nga kjo shifër janë aprovuar 1 156 rimbursime. Sipas ATK-së, koha mesatare e shqyrtimit të rimbursimeve të aprovuara është 20 ditë



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë me dije se për periudhën janar-tetor numri i kërkesave për rimbursim të TVSh-së, TAP-it dhe TAK-ut është 1 787. Në këtë kontekst, ATK-ja ka njoftuar se janë aprovuar 1 156 rimbursime, prej tyre 1 098 lëndë janë aprovuar me aktivitet (kategoria A dhe B) dhe 65 lëndë janë aprovuar me kontrolle (kategoria B me kontroll dhe C). Sipas ATK-së, koha mesatare e shqyrtimit të rimbursimeve të aprovuara është 20 ditë. "Në funksion të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me

rimbursimet, ATK-ja ka themeluar Divizionin për Menaxhimin e Rimbursimeve. Ky divizion menaxhon komplet procesin e rimbursimeve nga një qendër e vetme në zyrën qendrore të ATK-së përmes modulit të rimbursimit. Përmes këtij moduli, bazuar në kriteret e përcaktuara nga ATK-ja, të gjitha kërkesat për rimbursim në mënyrë automatike nga vetë sistemi, kategorizohen në tri kategori, si: A, B dhe C. Menaxhimi i rimbursimeve është funksionalizuar në sistemin elektronik 'EDI' dhe është në dispozicion për tatimpaguesit, të cilët bëjnë kërkesë për rimbursim, si: për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh), Tatimin në të Ardhura Personale (TAP) dhe Tatimin në

të Ardhura të Korporatave (TAK)", është thënë në njoftimin e ATK-së. Ky institucion ka theksuar se përmes këtij shërbimi tatimpaguesi mund të informohet se deri ku ka arritur të shqyrtohet nga ATK-ja kërkesa e tij për rimbursimin e dërguar më parë. Më konkretisht, përmes shërbimit "Menaxhimi i rimbursimeve" tatimpaguesi mund të informohet për: datën e

kërkesës për rimbursim, vlerën e kërkuar, llojin e tatimit, statusin e shqyrtimit të kërkesës (në pritje/përfunduar/refuzuar), kategorizimin e tatimpaguesit sipas rregullores së brendshme të ATK-së, A, B apo C, datën e përfundimit, si dhe vlerën e aprovuar. "Për periudhën janar-tetor numri i kërkesave për rimbursim të TVSh-së, TAP-it dhe TAK-ut është 1 787, ndërsa rimbursime të aprovuara janë 1 156, prej tyre 1 098 lëndë janë

aprovuar me aktivitet (kategoria A dhe B) dhe 65 lëndë janë aprovuar me kontrolle (kategoria B me kontroll dhe C). Koha mesatare e shqyrtimit të rimbursimeve të aprovuara është 20 ditë. Gjatë kësaj periudhe janë refuzuar 557 kërkesa për rimbursim dhe prej tyre 548 janë me aktivitet (kategoria A dhe B), si dhe 9 janë refuzuar me kontrolle (kategoria B me kontroll dhe C)", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Lansohet pullat postare 'Bukuritë natyrore të Kosovës'

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Posta e Kosovës ka lëshuar të enjten në qarkullim pullat e reja postare të titulluara "Bukuritë natyrore të Kosovës". Me këtë rast, posta ka theksuar se Kosova ka bukuri të shumta natyrore. "Republika e Kosovës ka shumë bukuri natyrore me pyjet e dendura, liqenet akullnajore, shpellat dhe ujëvarat, të cilat krijojnë një mjedis magjepsës dhe mjaft atraktiv për vizitorë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë. Pamjet e këtyre dy pullave postare prezantojnë bukuritë e dy liqeneve malore në pjesën perëndimore të Kosovës,

Liqenin e Kuqishtës, i cili ndodhet në Bjeshkët e Nemuna me lartësi mbidetare 1 970 metra, si dhe Liqenin e Gjeravicës, në majën e Bjeshkës së Gjeravicës me lartësi mbidetare rreth 2 200 metra", është thënë në komunikatën e Postës së Kosovës, duke shtuar se filatelia e Postës së Kosovës këtë radhë e prezanton shtetin e Kosovës përmes bukurive natyrore të prezantuara në këto dy pulla postare, të cilat janë vepra të autorit Mensur Gashi që ia ka dhuruar Postës së Kosovës për të qenë në interes të promovimit të shtetit tonë.



Miratohet në parim projektbuxheti i Shqipërisë për vitin 2021



TIRANË, 5 NËNTOR - Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në parim projektbuxhetin për vitin 2021. Në favor të këtij projektbuxheti kanë votuar 87 deputetë, nëntë kanë qenë kundër dhe dy kanë abstenuar. Projektbuxheti fillimisht ka kaluar në

komision, ndërsa është theksuar se në këtë projektbuxhet prioritet do të jetë shëndetësia për shkak edhe të pandemisë që ka goditur të gjithë botën. Një pikë tjetër e rëndësishme të ky projektbuxhet është

fokusimi te rindërtimi si dhe heqja e taksave për bizneset e vogla. Mazhoranca e ka cilësuar projektbuxhetin si një përgjigje të duhur ndaj pandemisë si një ndihmë edhe më të madhe për rindërtimin apo rimëkëmbjen ekonomike.

Ministri Krasniqi: Ekonomia digjitale hap mundësi të shumta zhvillimore

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka marrë pjesë në takim virtual të ministrave të tregtisë të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Samtimit të Sofjes. Në këtë takim është biseduar për ekonominë e gjelbër, agjendën digjitale dhe për lëvizjen e të rinjve. Krasniqi në fjalën e tij ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për promovimin e politikave të ekonomisë së gjelbër, për energjinë e pastër, për efikasitetin e energjisë dhe për temat e mbrojtjes së ambientit



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në takim virtual të ministrave të tregtisë të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Samtimit të Sofjes, është biseduar të enjten për ekonominë e gjelbër, për agjendën digjitale dhe për lëvizjen e të rinjve. Me këtë rast, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për promovimin e politikave të ekonomisë së gjelbër, për energjinë e pastër, për efikasitetin e energjisë dhe për temat e mbrojtjes së ambientit. Sipas tij, për zhvillimin e ekonomisë së gjelbër nevojitet një qasje integrale në politikë duke përfshirë shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë. Më tutje, ai ka thënë se kalimi në një ekonomi të gjelbër kërkon një mentalitet të ri të të

bërit biznes, sepse kërkohen lloje të tjera të aftësive dhe shkathtësive në tregun e punës, që të rinjtë mund të punojnë në sektorë të ndryshëm dhe të jenë të aftë për të punuar si pjesë e ekupeve shumëdisiplinare. “Qeveria e Kosovës është duke shqyrtuar një zvogëlim, apo heqjen e TVSh-së, e cila do ta ulte koston përfundimtare të instalimit të paneleve solare për familjet dhe sektorin privat, si dhe do ta ulë kohën e kthimit të investimit. Një masë e tillë do ta gjallëronte sektorin dhe do ta rriste punësimin”, është shprehur Krasniqi. Kosova ka folur edhe për mundësinë e krijimit të një tregu (artificial) të përkohshëm, që mund të arrihet përmes investimeve në projektet për efikasitetin në energji dhe matësit RES (burimet e energjisë së ripërtërishtme) për zbatimin e furnizimit me energji solare në objektet publike, siç janë

shkollat dhe spitalet, që do të përfitonin të dyja palët duke punuar së bashku për t'i përbushur objektivat e furnizimit me energji të rinovueshme, e që do të kontribuonin në kursime të konsiderueshme për buxhetin e Kosovës.

Po ashtu, ministri Krasniqi ka theksuar se zhvillimi i sektorit privat dhe i ekonomisë digjitale kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe kjo vlen edhe për Kosovën. “Ekonomia digjitale hap mundësi të shumta. Në ditët e sotme inovacioni ka ndryshuar

ekonomitë dhe tregjet duke i ridizajnuar relacionet në mes të furnizuesve dhe konsumatorëve, duke u bërë kështu element kyç për rritje, inovacion dhe krijim të vendeve të punës”, ka deklaruar Krasniqi. Sipas tij, Qeveria e Kosovës është duke punuar që të jetë në hap me kohën dhe zhvillimet teknologjike, sidomos në këtë periudhë pandemie e cila ka dërguar sinjal se ekonomia digjitale është ekonomia e së ardhmes dhe rrjedhimisht ne mbështesim agjendën digjitale për Ballkanin Perëndimor. Gjatë këtij takimi ministri

Krasniqi u ka bërë thirrje përfaqësuesve të BE-së që t'u mundësohet lëvizje e lirë qytetarëve të Kosovës në vendet e BE-së dhe në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor sepse ekonomia digjitale nuk është e plotë nëse personat dhe sidomos të rinjtë nuk lëvizin lirshëm. Në fund, ministri Krasniqi ka përgëzuar vendet e CEFTA-s të cilat tashmë kanë ratifikuar në parlamentet e tyre Protokollin shtesë 6, një protokoll i cili, ndër të tjera, zbatohet dhe respektohet në tërësi, ku do t'i ofrojë rajonit një perspektivë zhvillimore.

Rukiqi kërkon unitet politik për garantim të proceseve ekonomike

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se zhvillimet e fundit të lidhura me veprimet e Gjykatës Speciale, përkatësisht konfirmimi i aktakuzave për krerët institucionalë dhe të luftës për liri, po përcillen me shqetësim të madh në komunitetin e biznesit. “Reagim i komunitetit të biznesit për zhvillimet e fundit në vend të lidhura me veprimet e Gjykatës Speciale. Zhvillimet e fundit të lidhura me veprimet e Gjykatës Speciale, përkatësisht konfirmimi i aktakuzave për krerët institucionalë dhe të luftës për liri, po përcillet me shqetësim të madh në komunitetin e

biznesit. Ne besojmë fuqishëm që lufta e drejtë për liri dhe pavarësi nuk mund të gjykohej e as të zhvlerësohet në asnjë gjykatë”, ka shkruar Rukiqi në profilin e vet në “Facebook”. Më tutje, ai ka thënë se këto zhvillime kanë lëkundur themelet e stabilitetit institucional. “Andaj, i bëjmë thirrje spektrit politik dhe të gjithë aktorëve në vend të vepronjë me unitet, për t'i garantuar proceset politike dhe ekonomike të cilat janë vendimtare për mirëqenien e qytetarëve të Republikës të Kosovës. Komuniteti i biznesit është i gatshëm për ta dhënë kontributin e vet në këto zhvillime sfiduese për vendin”, ka shkruar Rukiqi.



Haskuka inspekton punimet në një shkollë të Prizrenit

PRIZREN, 5 NËNTOR (ER) - Me rastin e fillimit të punimeve për ndërtimin e aneksit të ri në Shkollën Fillore "Dy Dëshmorët" në fshatin Arbanas (Serbicë e Poshtme), kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Xhemile Thaçi-Vezgishi, kanë vizituar hapësirën ku do të ndërtohet ky aneks. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka deklaruar se objekti i ri dykatësh do të ketë një sipërfaqe prej 906 m², duke përfshirë 9 klasa mësimore,

hapësirat për kabinet dhe pjesë të tjera me hapësira moderne të cilat do t'i plotësojnë kushtet e nevojshme për një edukim cilësor. Po ashtu, kryetari Haskuka, duke e falënderuar Drejtorinë Komunale të Arsimit për punën e realizuar, ka deklaruar se gjatë ditëve në vijim do të vazhdojnë të punojnë për përfundimin e punimeve edhe në shkollat e tjera të Komunës së Prizrenit, për të krijuar hapësira dhe mjedise sa më kualitative dhe të përshtatshme për një edukim cilësor.



Rregullohet ndriçimi publik në fshatin Stantërg të Mitrovicës

MITROVICË, 5 NËNTOR (ER) - Në kuadër të rregullimit të ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Mitrovicës, para disa ditësh ka përfunduar rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Stantërg. Me rastin e funksionimit të ndriçimit publik në këtë fshat, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, ka thënë se pas rregullimit dhe asfaltimit pothuajse të të gjitha rrugëve në Stantërg, tani kemi filluar fokusimin në një aspekt mjaft të rëndësishëm infrastrukturor, siç është ndriçimi, që është përfshirë me mbi 70 për qind të rrugëve në ato lagje. Dhe sipas drejtorit Muja, projekti i rregullimit të ndriçimit publik në vendbanimet e Komunës së Mitrovicës është në proces e sipër dhe brenda këtyre muajve do të fillojë rregullimi i ndriçimit të rrugëve në fshatin Kçiq i Madh, Kçiq i Vogël, si dhe në Tunel të Parë.



160 studentë të Drenasit përfitojnë bursë

DRENAS, 5 NËNTOR (ER) - Komuna e Drenasit ka publikuar listën e përfituesve të bursës komunale për studentët e vitit akademik 2020/2021. Përfitues të bursës komunale janë 160 studentë të Komunës së Drenasit të cilët i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara sipas konkursit. Këto bursa që kanë për synim

ngritjen e cilësisë së arsimit janë ndarë për studentët që studiojnë studimet në universitetet publike për vitin akademik 2020-2021. Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, ka përgëzuar përzgjedhjen e bursistëve, duke i uruar suksese në të ardhmen dhe përfundim të suksesshëm të studimeve me rezultate sa më të mira.



Fillon asfaltimi i dy rrugëve në Marali të Malishevës

MALISHEVË, 5 NËNTOR (ER) - Në fshatin Marali të Komunës së Malishevës ka filluar asfaltimi i dy rrugëve, hapja e të cilave kishte filluar më pak se një muaj më parë. Asfaltimin e rrugëve e kanë parë nga afër drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Malishevës, Ahmet Morina dhe anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Hashim Vrenezi, të cilët edhe i kanë uruar banorët që jetojnë në këto dy rrugë. Bëhet fjalë për asfaltimin e rrugës "Mulla Selimi" e gjatë 500 metra dhe rruga "Naim Frashëri" e gjatë 100 metra, hapja dhe rregullimi i të cilave kishte

filluar më 11 tetor dhe tani për më pak se një muaj rrugët janë rregulluar dhe po asfaltohen.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Malishevës, Ahmet Morina, i ka uruar banorët dhe ka thënë se "qeveria komunale mbetet e përkushtuar për realizimin e të gjitha projekteve të cilat edhe janë kërkesa dhe nevoja të qytetarëve në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës".

Hapja, zgjerimi dhe rregullimi i këtyre rrugëve, deri në asfaltimin e tyre, është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Mid'hat Abdyl Frashëri, një nga personalitetet më të shquar të Evropës



Nga: Uran BUTKA

Lindi në Janinë më 25 mars 1880. I ati, Abdyli, ishte në Prizren, në krye të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur lindi Mid'hati. Abdyli, Naimi dhe Samiu u morën direkt me edukimin e tij.

Në vitin 1897 themeloi bibliotekën "Lumo Skëndo" dhe mori pjesë aktive në botimin e "Kalendarit Kombiar" bashkë me Kristo Luarasin. Shkrimet e para me temë rilindëse i botoi qysh në moshën 16 vjeç, madje puna e parë ishte për Skënderbeun. Pas studimeve, punoi në administratën osmane në Stamboll dhe mandej në Selanik, ku themeloi Klubin shqiptar dhe gazetën "Lirija" (1908).

Mid'hati u zgjodh kryetar i Kongresit të Manastirit, (1908) që hartoi një program kombëtar prej 18 pikash dhe vendosi alfabetin krejtësisht latin të gjuhës shqipe. Ai qe nismëtar i thirrjes së Kongresit arsimor të Elbasanit (1909) për çeljen dhe administrimin e shkollave shqipe dhe të Normales për mësues. Botues i revistës kulturore "Dituria", një enciklopedi e jetës dhe monument i kulturës shqiptare (1897-1929). Veprimtar i shquar i Pavarësisë.

Pjesëmarrës në tubimin e Shkupit (tetor 1912) ku u vendos te shpallej Pavarësia e Shqipërisë. Delegat i Pejës dhe Gjakovës, Plavës e Gucisë dhe

mandej dhe i Elbasanit në Kuvendin e Vlorës (1912). Firmëtar i Pavarësisë Kombëtare dhe anëtar i qeverisë së Ismail Qemalit, ministër i Punëve të Përgjithshme. Në vitin 1914, ministër në qeverinë e Princ Vidit. Largohet nga Shqipëria, kur nis rebelimi haxhiqamist, që i dogji edhe shtëpinë me gjithë dokumentet në Elbasan. Emigrant në Zvicër, Sofje, Bukuresht. Në Sofje boton veprat e para: "Letra nga një udhëtim në Zvicër", "Hi dhe shpuzë", "Popullsia e Epirit", "Pritmi i Shqipërisë", si edhe gazetën në gjuhën frëngjisht "L'indipendance Albanaise", ku propagandonte dhe mbronte çështjen shqiptare. Gjatë Luftës së Parë Botërore u internua në Moldavi, në minierat e naftës dhe të vdekjes. Atje shkroi "Ditarin", kujtimet nga Rumania.

Ministër pa portofol në qeverinë e Turhan Pashës (1918). Delegat i qeverisë në Konferencën e Paqes në Paris (1919), njëherësh delegat i "Vatrës" ShBA në atë konferencë, i Komitetit "Mbrojtja e Kosovës" dhe i shqiptarëve të Turqisë. Në Lozanë dhe Gjenevë, qendra të propagandës dhe botimeve të kombeve, Mid'hati botoi në vitin 1919-një sërë veprash të rëndësishme historike në gjuhën frëngjisht si "Rilindja shqiptare", "Shqiptarë e sllavë", "Shqiptarët në vend të tyre dhe jashtë atdheut", "Rivendikimet shqiptare", "Çështja e Epirit", si edhe qindra artikuj,

promemorie, letra, ese, memorandume drejtuar Konferencës së Paqes, qeverive të Fuqive të Mëdha dhe personaliteteve politike e kulturore të Evropës si edhe shkrime botuar në gazetë dhe revistat më prestigjioze të Evropës.

Gjithashtu, i dërgoi Presidentit Uilson të ShBA-së një mesazh për ta njohur me çështjen shqiptare dhe një aneks-promemorie të shoqëruar me gjashtë harta etnografike, që ndikuan tek Presidenti Uilson për mbrojtjen e çështjes së rrezikuar shqiptare, në prag të copëtimit. Kryetari delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1920-1922) dhe në Lidhjen e kombeve, ku mbrojti si askush tjetër çështjen shqiptare. Në vitin 1923 emërohet Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Greqi, ku u shqua për rregullimin e marrëdhënieve shtetërore me Greqinë, mbylljen e Sillogjeve antishqiptare dhe mbrojtjen e çështjes çame, ndalimin e shkëmbimit të shqiptarëve si turq në Turqi (1923-1925) dhe kundërshtimin e kolonizimit të Çamërisë me kolonë grekë.

Dha dorëheqjen si ambasador në vitin 1925, kur politika e shtetit shqiptar nuk përputhej më me parimet e tij, pikërisht kur Shën Naumi dhe Vermoshi iu dhanë Jugosllavisë nga Zogu, me protestën "Asgjë të japim nga trupi i mëmëdheut tonë".

Në vitet 1925-1939 u mor me punë kulturore dhe studimore,

themeloi librarinë "Lumo Skëndo" në Tiranë dhe botoi një sërë veprash të rëndësishme si "Plagët tona", "Gruaja", "Udhëtarët e huaj në Shqipëri", "Liga e Prizrenit", "Përshtypjet e udhëtimit", "Bibliografite", etj.

Më 8 prill 1939 hodhi themelet e organizatës nacionaliste "Balli Kombëtar" si një alternativë antifashiste me program "Nacionalizma shqiptare", 1939. Në vitin 1942 publikoi programin e Ballit Kombëtar "Dekalogu", një program nacionalist për një Shqipëri etnike dhe demokratike dhe socialdemokrat nga pikëpamja sociale. Gjatë Luftës së Parë Botërore udhëhoqi luftën e nacionalistëve kundër pushtuesve nazifashistë dhe paqen ndërmjet shqiptarëve.

Ishte organizatori kryesor i Kuvendit të Mukjes (3-4 gusht 1943) dhe i Marrëveshjes së Mukjes për një luftë të përbashkët kundër okupatorëve, në krah të Aleatëve të mëdhenj Antifashistë. Pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes nga komunistët dhe emisarët jugosllavë, ai u përpoq të ndalte Luftën civile (1943-1945) dhe u përball me terrorizmin komunist. Emigroi nga Shqipëria pas pushtimit komunist të saj (nëntor 1944) për ta vazhduar luftën kundër regjimit komunist me mjete demokratike me ndihmën e vendeve Perëndimore. Në emigracion organizoi qëndresën, por edhe edukimin e

shkollimin emigrantëve politikë shqiptarë (në kampet Gramo, Santa Fara, Regio Emilia etj.) me konferencat, kurset, shkollën "Besnik Çano", mësimin e gjuhëve të huaja dhe botimin e revistës "Flamuri".

Në vitin 1949 në bashkëpunim me Aleatët anglo-amerikanë themeloi në Francë, më 26 gusht 1949 Komitetin "Shqipëria e Lirë" – qeveria shqiptare në emigracion. Qëllimi i Komitetit "Shqipëria e Lirë" ishte lirim i Shqipërisë nga diktatura komuniste dhe vendosja atje e një sistemi demokratik sipas modeleve më të përparuara perëndimore. Mid'hat Frashëri u zgjodh kryetar i komitetit dhe nga BBC në Londër dhe shpalli programin e Komitetit, me 6 shtator 1949.

Komiteti "Shqipëria e Lire" u vendos me seli në Nju-Jork, ku nisi veprimtarinë. Për fat të keq, vdiq papritur më 3 tetor 1949. Vdekja e tij mbetet e dyshimtë, ndonëse u njoftua një atak kardiak. Mendohet se vdekja e M. Frashërit u shkaktua nga një ndërhyrje e Sigurimit rus, nëpërmjet agentit Kim Filbi, sipas vendit të qeverisë shqiptare për ta zhdukur Mid'hat Frashëtin (dok. arkivi i Ministrisë së Brendshme).

Vdekja e Mid'hat Frasherit ishte një humbje e madhe për Shqipërinë dhe kombin shqiptar, por edhe më gjerë. Ai ishte figura më e madhe e Kombit tonë, njëherësh edhe një nga personalitetet më të shquar të Evropës në atë kohë. /Telegrafi/



AKADEMIK PROF. DR. EDMOND NASI PINGULI VLERËSON PROF. DR. EQREM ZENELAJN PËR PUNËN SHKENCORE ATDHETARE DHE HULUMTIMET E TIJA NË DOBI TË HISTORISË KOMBËTARE

“JEMI KËTU NË VËND TËNË, QË PA LERË DIELL E HËNË”



**EDMOND NASI
KONSTANTIN PINGULI**
ANËTAR I AKADEMISË SË
SHKENCAVE TË SHQIPËRISË
ANËTAR I AKADEMISË SË
SHKENCAVE TË EVROPËS

Uroj që mesazhi im t’ju gjejë mirë me shëndet si ju dhe familjen tuaj. Ju falenderoj për dërgimin e librave, të prodhuar nga mendja dhe krijimtaria juaj e shkëlqyer në dobi të ndriçimit të së vërtetës aq të dashur dhe të dhimbëshme të historisë së lashtë të rrënjëve të Kombit dhe popullit tonë. Me shumë besim, dashuri, përkushtim, forcë, sakrificë dhe energji keni filluar të bëni realitet këtë punë sa të bukur, të ndritur dhe të madhe. Në rrugën e gjatë, të mundimshme, me sakrificë dhe duke dhënë gjithçka nga vitet e jetës tuaj, ju do të jeni krenar për sot dhe në të ardhmen me dobinë e patjetërsueshme, që i keni sjellë mëmëdheut tonë.

Qofsh gjithmonë i lavdëruar për shpirtin luftarak dhe fisnik, që ju trashëgoni nga të parët tuaj, si bir besnik i një tradite të lashtë, duke shfaqur virtutet më të larta dhe të

çmuara “SHQIPTARIT PATRIOT”. Sot Pellazgët pranohen botërisht si “popull historik”, që jetoi dhe lulëzoi për disa mijëvjeçarë në lashtësi. Dhe përderisa është pranuar gjithashtu botërisht, se në Ballkan nuk ka komb më të lashtë se “Shqiptarët”, dashur pa dashur i nënkupton ata si të vetmit trashëgimtarë të Pellazgëve.

Pas dëshmimeve të “DIODORIT”, alfabeti Pellazg ishte i vetmi në poezinë evropiane para “HOMERIT apo PLINIT-PLAKUT”, se ky alfabet u çua deri në “Lacium nga Pellazgët”. Pas pohimeve të “HERODOTIT, TUKIDIDIT, PLATONIT” me shokë, se pellazgjishtja gjallonte akoma në Ballkan gjatë shekujve V-IV p.e.s., pas zbulimit të mbishkrimeve të bëra në Lemnos, Italinë e Jugut, te Mesapët, etj. dhe së fundi atyre “të platitura” të “EPIRIT”, pellazgjishtja nuk kishte pushuar kurrë, pa u përdorur edhe me shkrim të paktën nga mijëvjeçari i dytë p.e.s dhe deri në agim të erës sonë.

Në mos për të pohuar, siç ka shumë të ngjarë, që “HOMERIT” ishte “Pinjoll Pellazg” kokë e këmbë, a nuk duhet pohuar të paktën e të paktave, “ndihmesa e kulturës Pellazge në kulturën Helene”, për deri sa kjo dukuri bie aq shumë në sy madje tek “HOMERIT” vetë?

“ILIADA dhe ODISEA” tingëllojnë, të vështruara nën dritën e re, si një himnizim i traditave dhe i

heronjve “PELLAZGË”. “DEMOKRITIT”, vetëm duke nxjerrë nga varri, sipas “PLINIT”, munda t’ia popullarizonte veprat paraadhesit të tij jo helen, i cili njihet qysh nga Lashtësia e thellë me emrin kuptimplotë “PELLAZG DARDANI”.

Po ashtu nga zanafilla Pellazge, pati qenë “DARES FRYGASI”, që na ka falur një “ILIADË” parahomerike, të shpëtuar falë mundit të “PTOLEME KENOIT” aty nga fundi i shekullit të parë. Pikërisht për një “ILIADË” të tillë pati pasur dijeni “ELIANI”, dy shekuj para Kenoit.

Ne kemi bindje të plotë, se nuk do të jetë e largët dita, kur prej trashëgimisë së pasur antike, dija përparimtare me mjete të bashkërenduara të disa disiplinave shkencore, ka për të dalluar traga të prekshme nga “Qytetërimi i Stërmoçëm Pellazg” si edhe nga bijat e tij Ilire, Trake, Paione, Etruske, Daune, Peukete, Mesape, Japige, etj.

Nëpërmjet hulumtimit të “Simboleve Dodonase”, si faktor i brendshëm me përmbajtje etnike, përvijohet lehtë mbi hartë, jo me hamendje ose sipas pohimesh subjektive, por mbi piketa të dokumentuara, objektive se:

“Shtirirja gjeografike e Pellazgëve të stërmoçëm dhe e ndikimit të tyre, të paktën e të paktave që nga Itaka, Leukada, Akarnania, Etolia, Tesalia Epirote deri në Labeati, duke përshkuar Dardaninë dhe

duke përfshirë Paioninë, Maqedoninë, Trakinë e Vjetër, si edhe shumë ishuj të Egjeut, Etrurinë, etj., etj.”.

Ky realitet objektiv, i ravijëzuar me anën e pranisë së dokumentuar të “Emblemave Pellazge” nëpër trevat përkatëse, përligjet edhe nga autorë të lashtë si:

Eskili (shekulli V-të p.e.s.): “Pellazgu, “Mbret i Argosit” në Peloponez i thotë “Danait”, se mbretëria e vet shtrihet deri në Strymon në Traki, Paioni edhe në malet e Dodonës”.

Helaniku (shekulli i V-të p.e.s.): “I biri i mbretit të tyre Pellazgut dhe Menipës është Frastori dhe i biri i tij Amyntori dhe i këtij Teutamidi dhe i këtij të fundit Nanai...”.

Straboni (Shekulli i I-rë p.e.s.): “Ndërsa Peneu ndan “Maqedoninë e Poshtme” dhe atë bregdetare prej Thesalisë dhe Magnezisë, Haliakmoni (Bistrica e Sotme) ndan “Maqedoninë e Sipërme” nga “Epirotët e Paionët”, sikurse e bëjnë këtë Erigoni (Cerna e Sotme), Aksi (Vardari i Sotëm) dhe lumenjtë e tjerë...”.

“...Paionët banojnë në viset rreth Lumit AKS...”.

Përforcohet ndjeshëm dëshmia e drejtpërdrejtë dhe e qartë e Helanikut, i cili pati jetuar gjatë midis Pellazgësh në Pela (Maqedoni) e përçark, se: “...Etruskët ishin Pellazgë...”.

Grekët, si armiq e varmihës të Pellazgëve, nuk mund të trashëgojnë asnjë lidhje Gjenetike me Pellazgët, sikundër e pranojnë haptazi edhe vetë disa nga historianët e tyre të njohur (G. KORDHATOS, M. SAQELLARIOS). Pikërisht, kjo është arsyeja përse ata, përveç humanizmit, adoptimit të “Panteonit Dodonas-Olimpas” si faktor i jashtëm, jo etnik:

“Nuk u përjetësua kurrkund, siç ndodhi te ne, tërësia absolute e “Simboleve Pellazge”.

Trashëgimia origjinale, e papërlyer, e gjithëmbarshme dhe ekskluzivisht, si faktor i brendshëm, vetëm në “Trojet Shqiptare”, me fytyrë drejt Amantisë, Bylisit, Shkodrës, Damastionit, Sintias, Sirmionit. Kurse sa më poshtë drejt jugut: Athinës, Korinthit apo Spartës (burime genocidi për Pellazgët), tradita e tyre do të vagëllojë, e ndryshuar, e përshtatur, e manipuluar, sipas nevojave të dyndësve të huaj....

Për mjedisin Arbëror, njohësi i zellshëm i së kaluarës tonë, shkencëtari hungarez LAJOSH TALOCI (1834-1916) gjykon:

“Nuk ekziston popull tjetër në Ballkan, as ai i Greqisë së Re, që të mund ta ndjekë historinë e fisit të vet, ashtu me rend kronologjik, qysh prej kohëve më të lashta gjer në ditët tona, sikurse “Populli Shqiptar”.

Zanafillën e Pirro-Molosit Burrit

prej Shtëpisë Mbretërore Aiakase na e dokumentojnë, pa më të voglin dyshim, kundërshtim a përgënjeshtim, miq e armiq të tij, aq e sigurt ka qenë kjo prejardhje. STRABONI na thotë :

“TEOPOMPI thotë, se “Fiset e Epirit” janë 14, më të dëgjuar nga këto janë “KAONËT dhe MOLOSËT”, sepse dikur kishin sunduar mbi të gjithë Epirin, “KAONËT” më parë dhe më vonë “MOLOSËT”, të cilët morën fuqinë për shkak të fisit mbretëror “AIKAS” dhe për shkak se në vendin e tyre ishte “Faltorja e Dodonës”, e vjetër dhe e dëgjuar....”.

JUSTINI na shpjegon se :

“Por, meqenëse u përmend këtu Epiri, duhet treguar diçka mbi prejardhjen e kësaj mbretërie. Si mbretëri e parë në këtë trevë, qe ajo e “MOLOSËVE”. Pastaj “PIRRO NEOPTOLEMI”, i biri i “AKILIT” pasi kishte humbur mbretërinë e trashëguar nga i ati, për shkak të mungesës së gjatë në kohën e “Luftës së Dytë të Trojës”, u vendos në këto vende, banorët e të cilave u quajtën në fillim “PIRRIDË”, pastaj “EPIROTË”. Më vonë, kur erdhi Pirroja Neoptolemi, për të pyetur Orakullin e Dodonës, rrëmbeu “LANASËN”, të bijën e “HERKULIT”. Nga kjo martesë ai pati 8 fëmijë....”.

PLUTARKU thotë se :

“...Neoptolemi, i biri i Akilit, me njerëzit që kishte sjellë me vete, pushtoi vendin dhe la pas vetes një dinasti mbretërisht, që u quajtën “PIRRIDË”, sepse ai kur qe fëmijë, ishte mbiquajtur “PIRRO dhe PIRRO” quajti njërin nga djemtë e tij....”.

APOLODORI na shpjegon se :

“Neoptolemi, si qëndroi dy ditë te Tened, sipas porosisë së THETIDËS, u nis më këmbë bashkë me “HELENIN” për të “MOLOSËT”. Varrosi “FOINIKSIN”, i cili vdiq rrugës

dhe si fitoi betejën, u bë “Mbreti i Molosëve” dhe lindi nga “Andromaka” (e shoqja e Hektorit të Trojës të cilën e kishte kapur rob) “MOLOSIN”....Kur PELEU, i dëbuar nga Fthia prej djemëve të Akastit, vdiq, mbretërinë e babait e mori Neoptolemi”.

Rreth 30km në juglindje të Apolonisë ngrihet qyteti “Bylis”, i themeluar, sipas STEFAN BIZANTIT, prej djalit të “AKILIT, PIRRONEOPTOLEMIT”, të pagëzuar rëndom “PELLAZG” nga dijetarët e lashtësisë.

Përrurimin e “BYLISIT” prej Pirro Neoptolemit, pinjollit të Akilit e faktin edhe një monedhë e prerë nga ky qytet 100% “PELLAZG”.

E shoqja e Akilit dhe nëna e Pirro Neoptolemit, themeluesit të “BYLISIT”, quhej “PIRRA”, sipas “HYGINIT”.

Në ishullin Lesbos të banuar nga Pellazgët, adhurrohej “NIMFA PIRRA”.

Gjatë maskimit të tij si vajzë në “Ishullin Skyros të Dolopëve Thesalas Epirotë”, vetë “AKILIT” thirrej, po ashtu, “PIRRA”.

Këtë emër, e mban edhe sot në Shqipëri fshati myzeqar “PIRRA” (11km në jugperëndim të Lushnjës, si edhe fshati “PIRRA” (50km në juglindje të Janinës, Molosi).

Në vazhdën e “ENIT” (shekulli III-të p.e.s.), “OVIDI” (shekulli I-rë) dhe “PRISCIANI” (shekulli VI-të) e cilësojnë shprehimisht “PELLAZG”, të birin e Akilit, “Pirro Neoptolemin”.

Lastari Pellazg i Akilit, Pirro Neoptolemi, do të lartësohet si hero, në hullinë e të jatit, nga “Saga” të tëra populllore Pellazge, të pasqyruara edhe në “poema epike” të shekujve VIII-të-VI-të p.e.s., si: “THESPROTIA, NOSTOI, TELETONIA, KYPRIA”....

Në këto legjenda u frymëzua “Thesalasi Epirot PINDARI” (518÷438) për “ODET” e tij me përmbajtje epirote; “EURIPIDI”

(480÷406) për “ANDROMAKËN” e vet me subjekt epirot; “ESKILI” (525÷456), “KEREMON” (shekulli I-rë), “PAPIN STACI” (45÷96), në tragjeditë e tyre mbi “Akilin”, të pasuara nga krijimet e “DION KRYOSOSTOMIT” (rreth 30÷117), “AUZONIT” (rreth 330÷395), etj....

Në pranverën e vitit 334p.e.s, njëzet e dy vjeçari “Aiakasi Aleksandri i madh”, i ndjekur pas nga një shpurë oborrtarësh e dijetarësh, ndalet në brigjet e Helespontit, te kodërvarri i “AKILIT”, pranë Kepit të Sigetit. Kishin kaluar afro 9 shekuj nga “Lufta e Dytë e Trojës”, të cilën shkencë historike e pranon si të zhvilluar me të vërtetë aty para vitit 1180 p.e.s., më fort të përfunduar nga moti 1200 p.e.s, por kujtimi i të rënëve ishte ende i gjallë. Pasi kreu flijimet e zakonshme, “LEKA” ia mbuloi “tumën” me lule stërgjyshit të tij. Ky fakt i dokumentuar nga shumë burime antike, ka një domethënie të qartë dhe kuptimplotë, sepse dihet tashmë botërisht se:

“Tumulimin e kanë zbatuar tejndanë “Pellazgët” dhe pasardhësit e tyre, por jo Helenët dhe pasardhësit e tyre....Edhe vetëm kjo rrethanë, e ballafaquar gjithashtu edhe me “tumulin e kushëritit të tij PATROKËL” prej vet Akilit, do të mjaftonte për të saktësuar përfundimisht Pellazgësinë e heroit.

Po përpara këtij “kodërvarri” do të përulëj “KONSTANTINI I MADH”.

Mbi bazat e këngës popullore, “HOMERI” i qëndisi një portret të gjithanshëm “Akilit Pellazg”, protagonistit të kryeveprës së vet, përafërsisht me po atë besnikëri historike, që t’i ruajë deri sot “Rapsoditë e Trimërisë Populli Shqiptar”.

Në veprën e “HOMERIT”, që 32 shekuj më parë :

“Spikatin tiparet Pellazge të trashëguara pikë për pikë deri te

Shqiptarët e sotëm si : burrëria, besa, nderi, krenaria, mikpritja, zemërbardhësia për dashamirin, urrejtja e pafund ndaj armikut, vëllazëria, ligjërimi i trimave me kujë dhe shkulje flokësh, e shumë të tjera.

Ka një përjasje të çuditshme midis vajtimit të Akilit për bashkëluftëtarin dhe farefisin e vet Patroklin dhe vajtimin të Lekë Dukagjinit për Gjergj Kastriotin, që është zakon karakteristik ky vetëm e vetëm te “Pellazgët dhe Shqiptarët”.

MARIN BARLECI (1504) jep këtë mesazh kuptimplotë :

“Arbërit janë fis bujar, fis mbretërisht, gjak Aiakasish. Njeriu në këtë botë ndjek gjurmët e gjakut dhe të fisit të vet. Ky ligj pra edhe Arbërit kanë shpirtin e Pirro Molosit, sepse prej tij rrjedhin. Pirroja, ti e di mirë, u quajt dhe me të drejtë, si një nga udhëheqësit më të mëdhenj e më të fuqishëm në botë...Dhe çfarë burri ka qenë Pirroja në daç për luftë, në daç për paqe, e dëshmojnë sa e sa dokumenta të lashtësisë....”.

Burime të tilla, për Pirron në veçanti dhe për Aiakasit në përgjithësi, nuk kanë të numëruar gjatë mijëvjeçarëve. Por gurrat besojnë, se janë të mjaftueshme për të faktuar se :

“Stërgjyshërinë e “Arbëve të Skënderbeut”, rrjedhimisht edhe tonën, jo vetëm me Pirro Molosin, por edhe me të parët e tij Aiakas....”.

Si pikë referimi për Pellazgët, pas Dodonës, vështirë të gjendet tjetër më e përshtatshme, se ajo e “Shtëpisë Molosë”, e cila shekuj të tërë thuhet është identifikuar me Dodonën, sepse i ka prirë kësaj “Kryeqendër Pellazge në Ballë të Molosëve” dhe të mbarë Epirotëve. Me fjalë të tjera, përbri Dodonës, “Dinastia Aiakase” sendërzon, si të thuash, binarin binjak, mbi të cilin ka rrjedhur vijimësia

“Etno-Kulturore e Pellazgëve Parahënorë”.

Barazimi historik “Aiakas = Pellazg” edhe pse aksiomë tanimë e provuar, do të përforcohet me disa prova të mëtejshme.

Në shekullin V-së p.e.s, HERODOTI i quan “MOLOSËT = PELLAZGË”, ashtu sikurse STRABONI gjashtëqind vjet më pas. Ky i pasmi, duke shfrytëzuar edhe dëshmitë e “HEKATEUT, HELANIKUT, TEOPOMPIT”, njohës të drejtpërdrejtë të Pellazgëve sikurse edhe “HERODOTI” :

“Ua shtrin cilësorin “PELLAZG” mbarë “Popullsive Epirote”, i bindur në këtë vlerësim, sidomos nga përvoja vetjake prej dëshmitari okular”.

“Vijimësinë historike të pashkëputur të Pellazgëve e vulosin shpesh lidhur me “Aiakasit” edhe dhjetra autorë”.

Pirro Molosi dhe bashkëshetësit e tij krenoheshin veçanërisht me katragjyshin e tyre “Aiakas Akilin Legjendar”.

“Mbarë Lashtësia Greko-Romake”, sikundër faktohet prej shumë autorësh si :

“DIODORI, STRABONI, PLUTARKU, PAUSANIA, EUTROPI, AUREL

VIKTORI” e të tjerë se :

“Të gjithë shfaqnin me bindje të plotë, pa asnjë hije dyshimi, për lidhjen stërgjyshore të “Akilit Legjendar” me “Pirron e Ledhëzës”, duke shkukur kështu nga rrënjët të ashtuquajturën “Grekëri” të “Fatosit Homerik”.

Por, ka shumë dëshmi për farefisninë e tij Pellazge, të cilat janë të shumta, sa detyrohemi të sjellim këtu vetëm disa prej tyre. PIRRO-BURRI ka vënë në qarkullim sasi të panumërta monedhash me shëmbëlltyrën e “Akilit Aiakas”, të cilat mund t’i gesh anekënd trojeve shqiptare.... Përball madhështisë së pazakontë të Pirros, qenë shtërnguar të mos ia hanë tërësisht hakun sikurse e dëshmojnë vlerësimet e mëposhtëme :

“POMPE TROGU-JUSTINI” (shekulli I-rë p.e.s dhe I-rë e.s.) :

“Të gjithë shkrimtarët janë thuhet njëzëri të mendimit, se asnjë “Mbret”, qoftë nga bashkëkohësit e Pirros, qoftë nga ata që kanë jetuar më përpara, nuk mund të krahasohet me atë. Rrallë mund të shihet, jo vetëm midis mbretërve, por edhe midis burrave të shquar, një njeri kaq pa të meta dhe kaq i drejtë... Aq mirë e njihje ai artin ushtarak, saqë edhe duke luftuar me “LISIMAKUN, DHEMETRIN, ANTIGONIN”, me këta mbretër të mëdhenj, dilte gjithmonë fitimtar. Kurse në luftat me “ILIRËT, SIKULËT, ROMAKËT dhe KARTAGJENËT”, Ai kurrë nuk u mund, por në pjesën më të madhe doli fitues. Atdheun e tij, një vend të varfër dhe të padëgjuar, me lavdinë e heroizmave dhe me shkëlqimin e emrit të vet, Ai e bëri me të vërtetë, të përmendur në të gjithë botën”.

“PLUTARKU” (shekulli I÷11) :

“Për aftësinë e tij të madhe në





rreshtimin e ushtrisë dhe dijet strategjike mund të shërbejnë si provë shkrimet, që ka lënë mbi këtë çështje. Thuhet, se kur pyet një herë "ANTIGON" (Mbreti i Spartës), se kush ishte komandanti më i mirë u përgjigj: "PIRROJA, po të arrij të plakët", duke dalluar këtë midis të gjithë bashkëkohësve".

PO AI: "HANIBALI" (Mbreti i Kartagjenës), sikurse mund të lexohet edhe në jetën e "SHIPIONIT", të parin midis të gjithë komandantëve për përvojë dhe shkathhtësi quajti "PIRRON", të dytin "SHIPIONIN" dhe të tretin veten".

PO AI: "...Për aftësinë e tij ushtarake, për trimërinë dhe vlerën personale, u quajt për një kohë të gjatë i pari midis mbretërve të kohës së vet".

PO AI: "Pirroja ndaj njerëzve të tij ishte i butë dhe në zemërim e sipër nuk rrëmbehej kurrë. Përkundrazi ishte i shpejtë e i rrëmbyer, për të shpërblyer shërbimet, që i bënin të tjerët. Kur vdiq "Aeropi", i erdhi shumë keq, jo aq se vdiq, sepse vdekjen e quante një gjë të natyrshme, por se shtyri punën me sot me nesër dhe nuk kishte mundur, t'ia shpërblyente shërbimet, që i kishte sjellë ai. Për këtë hidhërohej dhe shpesh herë e qortonte veten...".

"PAUSANIA" (shekulli II-të e.s.): "Prokli kartagjenas i dha epërsi Aleksandrit të Filipit të II-të për shkak të fatit të madh dhe qartësisë së veprave të tij, por, për sa i përket rradhitjes së kalorësve dhe taktikës strategjike kundër armikut, quajti më të aftë "PIRRON".

"DION KASI" (shekulli II-të+III-të e.s.): "PIRRO dallohej shumë nga mbretërit e tjerë të kohës, nga natyra e tij e shkëlqyer, arsimit i lartë, përvoja në çështjet shoqërore".

"TIT LIVI" (shekulli I-rë p.e.s.): "Kur e pyetën pastaj, se cilin vinte në vendin e dytë, "HANIBALI" iu përgjigj: "PIRRON", sepse ky ishte i pari, që i mësoi të tjerët, se si të vendosnin lëmin (fushimin)". "DIONIZI I HALIKARNASIT"

(shekulli I-rë e.s.): "Pirroja nuk ka qenë ndonjë komandant i zakonshëm, përkundrazi, siç e pranojnë të gjithë, Ai ishte më i famshmi ndër ata, që u dalluan në atë kohë". "ZONORAI" (shekulli XI-të+XII-të e.s.):

"Pirroja, i cili mbretëronte në të ashtuquajturin EPIR, dallohej nga të gjithë për shkathhtësinë, për edukatën e gjerë dhe përvojën". "PAUSANIA":

Pirroja në vitin 274 p.e.s., nëpërmjet një mbishkrimi publik, dënon ashpër militarizmin maqedonas, duke përfshirë këtu sidomos atë të Aleksandrit të Madh, kushëriut të dytë:

"Dhe "ZEUSIT" të Dodonës i kushtoi mburojat e marra maqedonasve, ku qe shkruar:

"Këta dikur plaçkitën Azinë plot ar, këta dhe Heladën deshën ta robërojnë, tani pranë shtyllave të Tempullit të ZEUSIT, varet plaçka e Maqedonisë mburracake".

"LUKIANI"- autor i veprës satirike "Dialogët e të vdekurve" (shekulli II-të

e.s.), ku vihen në lojë perënditë:

"Meriton të përmendet edhe Pirro Epiroti, burrë që pas Aleksandrit të Madh, në çështjet ushtarake zinte vendin e dytë dhe që i ka sjellë mijëra ndryshime fatit. Ky pra, u lutej perëndive, u bënte fli, u bënte dhurata, por kurrë nuk kërkoi prej tyre fitore ose dinjitet më të madh mbretëror, lavdi dhe pasuri të tepruar. Lutej vetëm për një gjë: të ishte i shëndoshë, sepse po të kishte këtë, të tjerat do t'i kishte vetë me lehtësi dhe kujtoj, se ai mendonte shumë mirë, duke arsyetuar kështu, se asnjë dobi nga të mirat e tjera nuk ka, për deri sa mungon shëndeti".

"CICERONI" (shekulli I-rë p.e.s.): "Dy gjeneralë na kanë rënë në qafë në zotërimin e Italisë, "Pirroja dhe Hanibali". I pari për shkak të ndershmërisë së tij, nuk na frymëzon tepër mëri. Tjetri, për shkak të mizorisë së tij, ka për t'u urrejtur gjithmonë nga qyteti ynë".

"SHARL MONTESKIË" (1689+1755): "Madhështia e Pirros nuk mbështetej veçse në cilësinë e tij

vetjake".

"TEODOR MOMSENIN" (1817+1903):

"Pirroja ishte më i denjë, që të mbante kurorën mbretërore, se "Filipi i II-të dhe Aleksandri i Maqedonisë...".

"PJER LEVEK":

"Gërmimet e Epirit, ende rudimentare, nuk kanë nxjerrë aspak në dritë dokumenta, që të dëshmojnë për helenizim të vendit nën Pirron".

Mbi themelet e traditës sonë të pasur popullore me: këngë, gojëdhana, legjenda, toponime, përmendore të lashta, botime, dorëshkrime, etj., vetëm hulumtimet e historiografisë Shqiptare, do t'ia japin "PIRRO MOLOSIT-BURRIT" vendin e merituar në të kaluarën e "BALLKANIT".

Tashmë mund të pohohet sheshit, se ashtu si ringjalli "Skënderbeu" lavdinë e adheut të "BURRIT" në shekullin e XV-të (15), po ashtu pati ringjallur "PIRROJA" në shekullin e III-të p.e.s. zulumën e dikurshme të "MËMËDHEUT TË PELLAZGËVE". Madhështia e Pirros qëndron në faktin se Ai diti, ta kuptojë përgjithësisht drejt krahun e historisë dhe t'i kushtohet me të gjithë fuqinë mendore dhe trupore përparimit të popullit, i cili i ishte mirënjohës dhe e përkrahu me gjithë zemër deri në fund, pa kursyer madje as

rrëke gjaku. Po t'i kishte munguar ajo bazë shoqërore aq e gjerë dhe intensive e ajo mbështetje aq e plotë, "BURRI I LEDHËZËS" nuk do të kishte arritur ato kulme të papara dhe kujtimi i tij nuk do të ishte trashëguar kurrsesi kaq i gjallë deri më sot as te ne dhe as në botë..."

Emisione të tilla monetare i kanë kushtuar Akilit gjithashtu:

"TESALIA EPIROTE që është atdheu i tij".

"LARISA TESALO-EPIROTE".

Përkatesinë etnike Epirote të vendlindjes së Akilit, Tesalisë (ku përfshihet edhe krahina-nën "FTHIA") e vërtetojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa ekuivok:

"HOMERI".

"HERODOTI".

"APOLODORI".

"STEFAN BIZANTI" (bazuar ndoshta tek "ERATOSTENI").

Tërthorazi e njëjta gjë pohhet edhe prej: "HEKATEUT, SIMONIDIT, EURIPIDIT, DIODORIT, STRABONIT, PAUSANIAS", etj.

"FILOSTRATI" dëshmon, se porositë mbi mënyrën e zhvillimit të krenimeve Tesale për nder të Akilit, niseshin posaçërisht nga "Dodona Pellazge".

10. Është fakt i provuar botërisht, se Akili adhurohej si "Perëndi tejendane Epirit" dhe në gjuhën e vendit, thirrej "Aspet".

Arbëreshi Ëngjëll Mashi (1785+1821), Thimi Mitkoja (1820+1890) dhe shumë studiues të tjerë e kanë përqasur këtë "glosë" Pellazge me fjalën Shqipe "i shpejtë". Shtojmë, se "HOMERI", mbi 60 herë i jep "Kreshnikut" (te "ILIADA") cilësorin e barazvlerës "Këmbëshpejtë".

Praninë e binomit "Akil-Aspet" në Epir, por jo gjetiu, e dokumentojnë 6 dijetarë të moçëm:

11. ARISTOTELI.

12. PLUTARKU.

ARISTONIKU I TARENTIT.

PTOLEMEU I EFEZIT.

HEZIKU I MILETTIT.

16. FOTI.

17. Devotshmëria e Akilit ndaj "ZOJZI-ZEUSIT PELLAZG" të Dodonës na e saktëson, në gojën e "Heroit", vetë "HOMERI":

"O ZEUS, dodonas e Pellazg, që

banon larg, që kujdesesh për Dodonën dimërkeqe, ku rreth janë Selët...".

Këtu vihen re epitetet, që i ngjit HOMERI Kryeperëndisë ZEUS....

"EPIKARMI", poet epirot, i mbiquajturi "Homeri i Komedisë", përgjerohej pas bashkatdhetarit të vet, "AKILIT".

"PLUTARKU", zë në gojë, se njëri nga shpëtimtarët e Pirro Molosit dy vjeçar, në vitin 317 p.e.s., quhej Akil, duke vërtetuar kështu dy çështje me rëndësi:

Devotshmërinë e epirotëve asimoti ndaj katragjyshit Pellazg, djalit të

"PELEUT dhe Nipit të AIAKUT".

Përkatesinë etnike johelene të epirotëve, përderisa këta, në kundërshtim të plotë me zakonet kategorik Grek, i përkujtonin trimat e rënë, duke ia përtëritur emrin te të gjallët.

Është i njohur veneracioni i Akilit ndaj "Lumit Sperke" të konsideruar si i

"shenjtë" prej "Orakullit të Dodonës Pellazge".

Është vrojtuar një "kult" i posaçëm i Akilit në "Ishullin Epirot të Leukadës". 22. "TETI" (THETI), e jëma e Akilit ishte Anëtare e Panteonit Pellazg "Dodona-Olimp", mbrojtëse e "Qytetit të Stërllashtë Pellazg, BUKETIT".

Për nder të saj pati prerë monedha vetë Pirro Molosi, krahas qëndrave të tjera "Pellazgo-Epirote" si: "Larisa, Perrebia", etj.

"AKILI, si biri i "PELEUT" dhe nip i "AIAKUT", ishte "PELLAZG" sa nga i ati aq dhe nga nëna".

Në mblyllje të këtij "mesazhi" dashamirës dëshëroj të paraqes një opinion sa interesant po aq real dhe kuptimplotë të dhënë nga Profesor Dhimitër Pilika, që tashmë njihet me punën e tij shkencor-historike të zbulimit të rrënjëve të "Kombit Shqiptar" edhe si "PELLAZGOLOG" i klasit të parë, i cili ka dhënë një opinion

sa të qartë, po aq edhe të rëndësishëm mbi mënyrën se si trajtohet teza e origjinës së popullit tonë nga studiues të ndryshëm. Më poshtë po jap ekzakt, se çfarë ka thënë ky shkencëtar erudit, që është një pasues dhe mbështetës i denjë i

"Pellazgologut Profesor SPIRO N. KONDA", i cili me plot të drejtë dhe nder është "Mësuesi" më i



madh dhe mendje ndritur në këtë fushë :

“Do të ishte tepër e habitshme, për të mos thënë kundër gjykimin të shëndoshë, që një komb me tradita mijëvjeçare si i yni, të priste, ndër shekuj, që origjinën t’ia rrëfente, t’ia mësonte, i pari, së largu, nga muret e kabinetit, një filozof matematikan i huaj, sado vigan, si, bie fjala, “Gotfrid Vilhelm Leibnici” (1646-1713) apo ndokush tjetër. Mëmëdheut tonë, që prej dhjetra shekujsh nuk i kanë munguar kurrë dijetarët rrënja-vendas, të shqetësuar drejtpërdrejt, për një çështje të tillë jetësore. Këta pikërisht e mbrojnë plot zjarr “Gurrën Parailire” të stërgjyshërve tanë, në kundërshtim të flaktë me “LAIBNICIN”, krye borizan i shpejtuar, që nga moti 1695, i kryefillit tonë prej Ilirëve, që janë tepër rioshë në Evropë. Mjafton të përmendim këtu eruditët tanë : Piro Molosin, Gjergj Kastriotin, Barlecin, Beçikemin, Bardhin, Bogdanin, Nikoll Ketën, Zef Krispin, Dorsën, Kamardën, De Radën, Ismail Qemalin, Samiun, Kondën, Kurrillën, Gjeçovin, pa numëruar të tjerë, mjeshtër të regjur në dijet mbi Ilirët, por megjithatë, tejndanë, flamurtarë të paepur, të rrjedhës më të lashtë, “PARAILIRE” të popullit tonë, sepse është “trashëgimtar dhe bartës i një përvoje autoktone dhjetra shekullore”. Së vërtetës absolute edhe në këtë mes, i afrohet veç, kush e ka më të ngritur shkallën e njohjes. Duke qenë një karakter kryekëput “Historik”, mu për këtë arsye, problemi i “etnogjenezës sonë” mbetet detyrimisht i pakapshëm prej orvajtjeve “gjuhësore të cekta”, të shkëputura nga historianë si ato të Laibnicit me pasues”. Me të drejtë dikush ka thënë se : “Që të flasësh dhe të konkludosh, se kush janë Shqiptarët, duhet patjetër, ta dish “Gjuhën Shqipe të Nënës”.

Gjurmimet më të reja të shkencës ekzakte të antropologjisë dokumentojnë qartazi gjithashtu rrëmbat “Parailire, Parahelene, Pellazge, të Shqiptarëve të Sotëm”.

Hulumtimet antropologjike të kurorëzuar në Kosovë në vitet 1980, rreth periudhës afro 8 shekullore të sundimit Romak, ligjërojnë po ashtu, për një themel të ngjeshur “Parailir, Paragrek, Autokton”, në popullsinë e kësaj “Treve Shqiptare”.

Studimet serioze historiografike, qindra faqëshe, të botuara gjatë viteve 1980 në Itali, theksojnë me plot gojë, se qytetet kryesore antike të “Gadishullit Apenin”, ua detyrojnë themelimin dhe qytetërimin “Pinjollëve Pellazgë”, që ishin Parailirë, të shpërngulur nga vatrën tona amtare, ose të gërshetuar ngushtësisht me “Dodonën Plakë” (M. PINCHERLE, D. BRIQUEL).

Edhe vetë historiografia greke



bashkëkohore e vulos, në mënyrë të padiskutueshme, jo vetëm zotërimin Pellazg, pra Parailirë, gjithandej në Ballkanin e dikurshëm, por edhe posaçërisht “autoktoninë e tyre Parahelene” (G. KORDHATOS, M. SAQELLARIOS, A. PULIANOS, e të tjerë).

Tejpërtej “Gadishullit të Ballkanit” dhe më gjerë, ndërshtrësizime “Parahelene”, mënyra e jetesës, kultura materiale, shoqërore, artistike, veprimtaria prodhuese si edhe onomanistika e paraardhësve tanë, shfaqen në fusha anembanë, ku spikat shkoqur “Lashtësia Jonë Pellazge”, Parailire...

Pseudostuduesit Serbë, që prej shekujsh, po rropaten, me mashtrimet më të paturpshme, për praninë e katragjyshërve “Arbërorë në Ballkan”, kryesisht midis shekujve II-të-XI-të të tërës sonë, duke synuar, përveç gllabërimit të Kosovës edhe atë të “Shqipërisë Mëmë”.

Dihet, se të dhënat shkrimore dhe mbishkrimore nuk zënë në gojë Ilirët veçse në shekullin e VI-të p.e.s. Këta përfillen si “ardhës” por jo “rrënjës”, ndërkohë, që prej një vargani kumtimesh nga më të “Stërlashtat, Pellazgët” cilësohen shprehimisht si bijë të “Tokës” të mbirë prej “DHEUT”, madje si “Para-Hënorë” ose si të gdhirë në Evropë, që përpara

shfaqjes së “HËNËS” në hapësirat qiellore.

Ndonëse astronomë të sotëm betohen, se “HËNA” është mbrujtur prej vorbullash pluhuri dhe të shpërndara qëkuri rreth lëmshtit tokësor (RIÇËRD DEVIDSON, 1985), etnogjenezës sonë do t’i mjaftonte, gjithsesi, veçse “Autoktonia Relative e Pellazgëve në Kontinentin e Evropës”.

Pas zbulimit pranë Janinës në vitin 1875 të Dodonës “Kryeqendrës Politike dhe Shpirtërore të Pellazgëve”, u disafishua vlera e informacionit historik, që buronte nga afro 200 autorë të vjetër Helenë, Romakë e të tjerë, të cilët këmbëngulin çiltrazi, për qëndrueshmërinë historike të këtij “Populli Pellazg”, që është “Parailir e Parahelen”.

Pellazgologjia moderne, e mbështetur gjithashtu mbi punimet e mbi 500 dijetarëve të kohës së re, duke u rritur dhe zgjeruar orë e çast në rrafsh universal, jo vetëm e quan pikësynim të vetën madhore vijimësinë “Pellazgo-Shqiptare”, por mbi të gjitha është në gjendje ta demostrojë këtë me saktësi matematike edhe nëpërmjet provash të pashfrytëzuara dora-dorës. (Kalimthi, gjatë motit 1980, tërheqin vëmendjen, veçan, punimet e studiuesve tanë

Mathieu Aref, Nermin Vlora, Skënder Rizaj....).

Mjerisht, arritjet novatore të shkencës ndërkombëtare nuk njihen si duhet. Tek-tuk ndonjë ithtar i së vjetrës, pa kurrfarë përgatitje historiografike kompetente, ndrydhet symbyllazi ndër njohuri të përcipta, të kapërcyera, pa u shqitur dot nga suaza e ngushtë “ILIRE”, me një ngulm shkencërisht të paligjshëm, “agnosticist”. Gjithashtu, faqëza mijëra dokumentash dhe dhjetra disiplinash shkencore, rreket ende më kot (vetëm me shkumë fjalësh, nga forca e inercisë, pa as edhe një kundër- dokument të vetëm), që të hedhë akoma edhe sot, qëllimisht apo jo, farën e dyshimit mbi rrënjët tona të patjetërsueshme “PELLAZGE dhe PARAILIRE”.

“A kanë ekzistuar PELLAZGËT” ? Shkenca bashkëkohore, me shumicën dërmuese të mjeshtërve të saj i përgjigjet : “PO”.

Të gjitha këto që unë parashtrova më sipër do të botohen në librat e viteve 2021, 2022, 2023..... dhe në vazhdim, sepse shumica e materialeve janë bërë gati dhe do të mbyllen. Gjithashtu në vazhdim të viteve të tjera, do të dalin libra të tjerë, sepse unë disponoj me dhjetra dhe do të vijmë nga jashtë me dhjetra të tjera, që mbështesin

plotësisht pikëpamjen time, për “Rrënjët e Kombit tonë Pellazg”. Studimi në këtë fushë, e ka ndezur dritën që rreth 50 vjet më parë, sepse kisha trashëguar një bibliotekë të pasur në gjuhën frënge nga të parët e mi. Njëkohësisht pasioni për historinë, gjeografinë (merresha që në rini me pullat e shteteve të botës), filozofinë, artet (pikturën, skulpturën) dhe muzika (klasike dhe moderne) kanë qenë prezente në qenien time, për arsye të kushteve shumë të mira që fatmirësisht unë ndodhesha në familje.

Kjo përveç shkencave ekzakte si : matematikë, fizikë dhe kimi, ku me aftësitë dhe përgatitjen time unë u diplomova në “Inxhinieri Ndërtimi”, ku po punoj prej 50 vjetëve (3 Korrik 1971).

Duke e mbyllur, ju uroj shëndet të gjatë, punë të lodhëshme, në dobi të lartësisimit të emrit të vërtetë, që meriton “Kombi Ynë dhe Populli Shqiptar”. Për këtë ideal të madh luftuam gjatë jetës së tyre shumë nga bashkatdhetarët tanë, të cilët luftuan dhe punuan me pasion, krenari, këmbëngulje dhe dashuri për këtë ideal të lartë dhe të shtrenjtë, që do të mbesi si fener ndriçues në rrugën e ndritur dhe të çmuar, për punën që duhet të bëjmë sa të vështirë dhe të nderuar, ne pasardhësit e denjë të tyre.

Nuk duhet të harrojmë kurrë sentencat e njerëzve të shquar dhe të popullit :

HEGEL :
“Intelektuali i vërtetë është ai, që i përkushtohet Kombit”.

HORACI :
“Është kënaqësi dhe nder të vdesësh për atdheun, por më kënaqësi është të jetosh për të”.

KONFUCI :
“Ose gjeje një rrugë, ose hape një rrugë, ose hapu nga rruga”.

XHORDANO BRUNO :
“E vërteta nuk ndryshon prej faktit, se besohet, ose nuk besohet nga shumica e njerëzve”.

VIRGILI :
“Fati ndihmon atë që guxon”.

NAIM FRASHËRI :
“Dritë e diturisë përpara do të na çojë”.

PROVERBA :
“Historitë janë mundësi dhe mundësitë janë shpresë”.

“Fëmijët prezantohen me emrin e mirë të prindërve dhe gjatë gjithë jetës krenohen me emrin dhe punët e mira të tyre”.

“Mendja mund të harrojë të kaluarën, por zemra jo”.

“Asgjë nuk ka rëndësi në jetë, nëse nuk ka parime”.


“E ardhmja është e njeriut analitik dhe kritik, si edhe nuk e merr informacionin, siç ia servirin, por guxon të hulumtojë”.

“Duaje atdheun si Shqipja follenë”.

KËNGË LABE 300 VJEÇARE
“MESAPLIK - VLORË”

“JEMI KËTU NË VËND'TËNË QË PA LERË DIELL E HËNË”.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ballkani në shtesë shpëton nga humbja, Llapi zhytet në krizë



Kryesuesi i Superligës, Ballkani, në minutat shtesë ka barazuar rezultatin në ndeshjen ndaj Feronikelit, duke shpëtuar në këtë mënyrë nga humbja. Ndërsa Gjilani ia ka thelluar edhe me shumë krizën Llapi, i cili tash është në pozitën e fundit në tabelë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në dy ndeshjet e fundit të xhiros së njëmbëdhjetë që u zhvilluan të enjten, derbi mes Feronikelit dhe Ballkanit përfundoi pa fitues (1-1), derisa Gjilani e mposhti Llapin (2-0). Skuadra lidere e Superligës, Ballkani, ka shpëtuar nga humbja në ndeshjen ndaj Feronikelit, pasi në kohën shtesë shënoi për rezultatin final 1-1. Në minutën e 13-të Adem Maliqi realizoi gol për epërsinë e vendësve. Gjashtë minuta më vonë provuan mysafirët ta barazojnë rezultatin, por Daku u ndal për mrekulli nga portieri Avdyli. Pjesa e parë u mbyll me këtë rezultat. Në pjesën e dytë rastet nuk munguan, por mysafirët arritën ta barazojnë rezultatin vetëm në minutën e katërt shtesë, kur Ermal Krasniqi e mposhti portierin vendës për rezultatin final 1-1. Pas kësaj ndeshje, Ballkani e ruan kreun me 22 pikë, kurse "Nikli" zë vendin e shtatë me 12 pikë. "Ishte ndeshje e vështirë, kundër një kundërshtari të fortë. E morëm një gol nga pakujdesia. Më vjen mirë që reagoi skuadra, sidomos në pjesën e dytë morëm ne iniciativën dhe në fund arritëm ta barazojmë rezultatin. Më vjen mirë që po largohemi me një pikë dhe të

pamposhtur nga këtu. Në pjesën e dytë ndryshuam stilin e lojës që solli rezultat", ka thënë pas ndeshjes Ismet Munishi, trajner i Ballkanit. Munishi është ankuar për mënyrën e ashpër të lojës që ka aplikuar Feronikeli. Në anën tjetër trajneri i "Nikli", Klodian Duro, është i bindur se skuadra e tij meritoi tri pikët nga derbi ndaj Ballkanit. "Mendoj se ne merituar tri pikët sepse kemi bërë një ndeshje shumë të mirë në të gjitha aspektet. Mos të harrojmë që përballë kishim një ekip si Ballkani që me meritë kryeson Superligën, por ne atë që dhamë gjatë lojës e pamë gjithë që Feronikeli është i fortë dhe në pak kohë do të rikthehet atje ku i takon kësaj skuadre. Më vjen keq për djemtë sepse dhamë gjithçka në fushë dhe në fund merituar tre pikët", ka deklaruar Duro.

Fitore të enjten ka shijuar Gjilani në përballje me Llapin (2-0). Portieri Koliçi e shpëtoi Gjilani në dy raste, derisa në rastin e parë serioz skuadra vendase arriti të kalojë në epërsi me golin e shënuar nga Fiton Hajdari. Dy minuta më vonë Hajdari humbi edhe një rast të mirë shënimi. Pjesa e parë u mbyll me rezultat 1-0, kurse në pjesën e dytë Gjilani humbi një mundësi të mirë për ta shënuar golin e dytë, pasi gjuajtjen e Hajdarit nga

pika e bardhë e ndali portieri Hoffman. Në minutën e 75-të Ardit Hila e dyfishoi epërsinë e vendësve, derisa në anën tjetër mysafirët provuan të shënojnë nëpërmjet Sadriut dhe Januzit por, pa rezultat. Pas kësaj ndeshje, Gjilani përforcohet në pozitën e tretë me 20 pikë, kurse Llapi është në vendin e fundit me vetëm pesë pikë.

SUPERLIGA

Feronikeli - Ballkani	1-1
Gjilani - Llapi	2-0
Trepça '89-Drita	0-1
Prishtina-Arbëria	1-0
Besa-Drenica	0-0

Tabela

1. Ballkani	11	26 pikë
2. Drita	9	22
3. Gjilani	11	20
4. Drenica	11	15
5. Prishtina	10	14
6. Trepça '89	11	14
7. Feronikeli	11	12
8. Arbëria	11	11
9. Besa	11	6
10. Llapi	10	5

Në xhiron e radhës takohen: Arbëria-Besa, Ballkani-Gjilani, Llapi-Trepça '89, Drita-Prishtina, Drenica-Feronikeli.

SHKURT

Zbulohet ora dhe stadiumi ku do të zhvillohet vëllazërore Shqipëri - Kosovë

Federata Shqiptare e Futbollit ka përcaktuar agjendën e "vëllazërores" mes Shqipërisë dhe Kosovës e cila do të zhvillohet më 11 nëntor. Kjo përballje është vendosur të zhvillohet në "Elbasan Arena" në orën 16:00. Është zgjedhur Elbasani duke qenë se impianti modern i "Air Albania" nuk është gati për shkak të fushës e cila është në fazë rikonstruksioni. Kujtojmë që në miqësoren e fundit të zhvilluar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë triumfuan dardanët me rezultatin e pastër 3-0. Asokohe kuqezinjët drejtoheshin nga italiani Christian Panucci.

Vdes në një aksident në Gjermani futbollisti 20-vjeçar nga Kosova

Një futbollist 20-vjeçar nga Kosova ka vdekur në aksident tragjik në Gjermani. Aksidenti ka ndodhur të dielën më 2 nëntor. Klubi i futbollit VfL-Ulm 1905 ka njoftuar se bëhet fjalë për Jetëllir Hasanin. "Të dashur miq, të dashur fansa. Na ka goditur një lajm i trishtuar. Shoku dhe bashkëlojtari ynë Jetëllir Hasani iku nga ne duke na lënë me zemër të thyer. Ne dëshirojmë t'i shprehim ngushëllimet tona familjes Hasani. Më datën 8 nëntor nga ora 10.00 deri në orën 15.00 do të zhvillojmë një aksion për mbledhjen e fondeve", thuhet në njoftimin e klubit gjerman.

Solskjaeri, afër shkarkimit

Manchester Unitedi pësoi humbje të mërkurën në Ligën e Kampionëve kundër Instanbul Basaksehirit, kurse trajneri Ole Gunnar Solskjaer po rrezikon të shkarkohet. Mediat në ishull raportojnë se në rast se Unitedi humb edhe në fundjavë kundër Evertonit, atëherë tekniku norvegjez do të shkarkohet dhe vendin e tij do ta zë Mauricio Pochettino, i cili vazhdon të jetë i lirë që prej largimit nga Tottenham Hotspuri.

Departamenti i Sportit do ta vazhdojë mbështetjen për FBK-në

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, të enjten ka prituri ushtruesin e detyrës të drejtorit të Departamentit të Sportit të Kosovës, Fitim Arifi. I pari i basketbollit të Kosovës e ka njoftuar Arifin për projektet e ndryshme të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe për mundësinë e bashkëpunimit mes dy palëve. Po ashtu, e ka njoftuar për Ligën Unike, që është një ligë mes Kosovës dhe Shqipërisë. Në anën tjetër, Arifi e ka njoftuar Fetahun për mundësinë e mbështetjes së FBK-së edhe në të ardhmen. Federata e Basketbollit të Kosovës ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Sportit të Kosovës dhe ky bashkëpunim pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndiham nga Departamenti i Sportit është shumë e nevojshme, sidomos në këtë periudhë, kur vendi po përballlet me pandeminë Covid-19.

Fillojnë punimet për ndërtimin e zveshtoreve në stadiumin 'Demush Mavraj'

ISTOG, 5 NËNTOR - Kanë filluar punimet për ndërtimin e objektit të zveshtoreve në stadiumin "Demush Mavraj" në Istog. Kjo do të jetë faza e parë e ndërtimit për këtë vit. Vitin

e ardhshëm do të vazhdohet faza e dytë (II). Në fazën e parë do të përfshihet kati i parë, ku do të jenë zveshtoret për futbollistë, zveshtoret për gjyqtarë, zyra për delegatë,

administrata, dhoma për doping, dhoma për fizioterapeut dhe këndi për fitnes. Me kompletimin e tërësishëm të projektit do të plotësohen kriteret strukturore të UEFA-së. Ky

projekt financohet nga Komuna e Istogut. Në foto mund ta shihni se si do të duket stadiumi "Demush Mavraj" pasi të kompletohet tërësisht ky projekt.



Bremeni nuk lejon që Rashica t'i bashkohet Kosovës

BREMEN, 5 NËNTOR - Skuadra e Werder Bremenit nuk do të lejojë që Milot Rashica t'i bashkohet ekipit përfaqësues të Kosovës për ndeshjet e këtij muaji për shkak të kufizimeve të koronavirusit në qytetin gjerman. Rashica u ftua nga trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, për ndeshjen miqësore kundër Shqipërisë më 11 nëntor në Elbasan dhe për dy ndeshjet e fundit në grup në Ligën e Kombeve kundër Sllovenisë në Lubjanë dhe ndaj Moldavisë në Prishtinë, por nuk do të jetë në gjendje të paraqitet. Kufizimet e vendosura nga autoritetet shëndetësore në Bremen për mbrojtje ndaj Covid-19 e kanë shtyrë klubin e Bundesligës të mos i lejojë lojtarët e vet t'u bashkohen kombëtareve të tyre përkatëse, sipas mediave të shumta gjermane. Sipas masave për mbrojtje ndaj virusit në Bremenit, një futbollist që kthehet në qytet nga jashtë shtetit duhet të futet në karantinë pesëditore, pavarësisht rezultatit të testit për Covid-19. "Asnjë lojtar nuk do të paraqitet për shtetin e vet përkatës. Vendimi është



marrë për shkak të rregullores nga autoriteti shëndetësor në Bremen, e cila thekson se lojtarët që kthehen nga vendet me rrezikshmëri të lartë të virusit duhet të futen në karantinë për pesë ditë", thuhet në një njoftim të Bremenit. "Ne e dimë se lojtarët dëshirojnë t'u bashkohen kombëtareve të veta, por ne nuk guxojmë të rrezikojmë duke e parë situatën e përgjithshme", ka thënë drejtori sporti i Bremenit, Frank Baumann. Sulmuesi anësor nga

Vushtrria s'u lejua të udhëtonte drejt Prishtinës as në humbjen e Kosovës 2:1 kundër Greqisë në stadiumin Fadil Vokrri në shtator. Rashica, po ashtu, mungoi në katër ndeshjet e fundit të Kosovës në dy muajt e fundit për shkak të një lëndimi në gju. Rashica do të mungojë në dy ndeshje vendimtare për fatin e Kosovës në Grupin 3 të Ligës C, pasi "dardanët" dëshirojnë ta shmangin rënien në Ligën D - kategorinë e fundit të kësaj gare.

SHKURT

Tare: Immobile dhe Strakosha do të jenë kundër Juves

Çfarë ndodhi me Immobilen, Leivan dhe Strakoshën që nuk ishin për sfidën e Ligës së Kampionëve ndaj Zenitit? Përgjigjen e jep drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, i cili u përpoq të hidhte dritë mbi kaosin e krijuar sa iu përket tamponëve. "Ne bëmë tamponë të rregullt javën e kaluar, i dorëzuar të gjitha testet, iu nënshtruar sërish testeve të premtën dhe të shtunën, rezultatet ishin negative dhe të dielën ata luajtën. Pastaj dje ndodhi e njëjta gjë si një javë më parë me Pereiran dhe Hoedt. Janë disa rezultate që konsiderohen ndryshe. Ne e kemi bërë veten plotësisht të disponueshëm dhe tani po presim vendimet përfundimtare. Jemi besimplotë dhe nuk ka nevojë të diskutohet për këtë. A do të jetë Ciro Immobile kundër Juves? Po, ne mendojmë se ai mund të luajë, sepse tamponi që bëri gjysmë ore pas atij të UEFA-s ishte negativ, ashtu siç ndodhi me Leivan dhe Strakoshën. Është një rast i ngjashëm me atë që ndodhi me Hakimin e Interit", ka thënë Tare.

Sezoni i ri në NBA fillon më 22 dhjetor

Në fund të një beteje disaditore fitoi sërish komisionari Adam Silver. Mungon vetëm zyrtarizimi, por sezoni i ri sportiv 2020-2021 në NBA do të nisë më 22 dhjetor, ashtu sikurse Silveri kishte kërkuar. Drejtuesit e NBA-së, pas një negociimi të gjatë me Shoqatën e Lojtarëve dhe pronarët e skuadrave, kanë rënë dakord që kampionati të nisë para Krishtlindjeve, duke hedhur poshtë idenë që sezoni të niste më 18 janar. Sezoni i rregullt do të ketë më pak ndeshje, 72 për çdo skuadër dhe do të ulen me 25 % udhëtimet nga njëri shtet në tjetrin. Do të shtohet numri i ndeshjeve të njëpasnjëshme (14 të tilla për çdo ekip, pra 2 ndeshje në 24 orë). Sipas planit të ri, sezoni i rregullt do të përfundojë më 16 maj 2021, ndërsa finalët "play-off" do të përfundojnë brenda 22 korrikut. Pra, një ditë para fillimit të Lojërave Olimpikë, çka u jep mundësi lojtarëve më të mirë të shkojnë në Tokio.

Interi bën ofertë për Messin

Leo Messi nuk ka ndërmend që ta rinovojë kontratën me Barcelonën dhe skuadrat e interesuara janë duke ndjekur me vëmendje zhvillimet rreth tij. Nga Spanja raportojnë disa lajme që bëjnë me krahë tifozët e Interit. Gazetari i njohur spanjoll, Eduardo Inda, bën me dije se "Suning" ka lëvizur për ta transferuar Leo Messin dhe ka bërë një ofertë shumë të rëndësishme në tavolinën e tij. "Rinovimi i Mesit është shumë i komplikuar. Për momentin nuk ka ndërmend që ta vazhdojë bashkëpunimin me Barcelonën dhe kam informacione që ka marrë një ofertë shumë të rëndësishme nga Interi. Në fakt ai ka kërkesa nga Interi, por edhe nga gjysma e botës. Futbollit italian është duke rilindur falë një ligji që ndihmon të huajt dhe i largon nga taksat", ka thënë Inda në "ElChiringuitoTv".

Rafael Nadal në klubin e legjendave, 1 000 fitore në karrierë

MADRID, 5 NËNTOR - Nuk mund të kishte vend më të mirë se Parisi për të arritur 1 000 fitore në karrierë (i pari në vitin 2002). Rafael Nadali u mundua shumë për ta mposhtur shokun e vet, Feliciano Lopez, në një duel që zgjati 2 orë e 39 minuta lojë. Tenisti nga Mallorca kaloi në raundin e dytë të turneut Paris Bercy dhe u bë lojtari i katërt që arriti një numër katërshifror fitoresh në turnetë ATP. Më mirë se ai kanë bërë vetëm Jimmy Connors, Roger Federer dhe i madhi Ivan Lendl. Ndeshja kundër Feliciano Lopez nuk ishte formalitet. Pavarësisht se tenisti që kishte përballë ishte 39 vjeç, mbetej rival i respektuar. Njihen mirë me njëri-tjetrin, madje janë miq. Nadal e nisi keq përballjen, duke u thyer në shërbim që në game-n e parë e, për rrjedhojë, e humbi setin hapës 4-6. Edhe më i ekuilibruar seti i dytë, të cilin Nadali e fitoi me vështirësi në "tiebreak" 7-5. Në setin final,



Nadalit i mjaftoi game i parë i fituar me shërbimet e kundërshtarit, për ta mbyllur 6-4 dhe të gjithë ndeshjen 2-1 me sete. Në raundin e dytë Nadali do të përballlet me australian Jordan Thompson. 1000

fitore në karrierë! Një moment historik dhe i jashtëzakonshëm në Paris, në qytetin më të dashur për spanjollin, pasi aty ka fituar plot 13 herë Roland Garros (i fundit, 11 tetorin e kaluar).

Ish-futbollisti i Juves: Ronaldo është injorant


Cristiano Ronaldo është rikthyer të luajë me Juventusin rregullisht pas disa javësh në izolim për shkak se doli pozitiv me Covid-19 në javën e parë të

tetorit. Portugezi rezultoi pozitiv sa ishte pjesë e Portugalisë në ndeshjet e tetorit dhe shpejt u rikthye në Torino për t'u vetizuar deri në

rezultatit negativ, që erdhi vetëm javën e kaluar dhe CR7 u rikthye në fushë. Ronaldo është kritikuar shumë nga ish-futbollisti i Juventusit, Pasquale

Bruno. "Ai është injorant. Për dy vjet në Itali s'ka qenë ende në gjendje ta mësojë gjuhën tonë. Ai shprehet ende në spanjisht. Me këtë ai tregon mosrespekt

për shokët e tij apo gjithë italianët", u shpreh 58-vjeçari. Ronaldo numëron 5 gola në 4 takime me Juventusin këtë edicion.



Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmenden në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, slovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.




Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pothuajse askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbremjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkanë, Ali Podrimja dhe botuar nga *Rilindja* më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: *Boshnjakët edhe mund ta barrojnë luftën, edhe ta barrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta barrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s'do ta barrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s'do ta barrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetëm atje, ne shqiptarët këndo.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €



PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



IZET SARAJLIQ

Përkthues: Salajdin Salihu
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjilanit
Opština Gjilan - Municipality of Gjilan



NJOFTIM I KËRKESËS PËR KUALIFIKIM KONCESION I PUNËVE

Sipas Nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-045 të Ligjit për Partneritet Publiko Privat

Nr. i PPP-se	GL-651	2	0	0	8	1	5	1	2
--------------	--------	---	---	---	---	---	---	---	---

I AUTORITETI KONTRAKTUES: KOMUNA E GJILANIT

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **PPP - Rehabilitimi dhe zhvillimi i Palestrës së Sporteve dhe Infrastrukturës përcjellëse, Pishina dhe Objekti i Akomodimit "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan**

IV.2 KRITERET E DHËNIES SË KONTRATËS: Tenderi ekonomikisht me i favorshëm

IV.3 INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1 Kushtet për marrjen e Kërkesës për Kualifikim (KPK)

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për Kualifikim / dokumenteve para-kualifikuese:
data: **25.11.2020**

IV.3.2 Afati kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje:

Data 27.11.2020 koha 14:00 vendi Zyra e Prokurimit, adresa: Bulevardi i Pavarësisë p.n., 60 000, Gjilan

IV.3.3 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data 27.11.2020 koha 14:30 vendi Zyra e Prokurimit, adresa: Bulevardi i Pavarësisë p.n., 60 000, Gjilan

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1 ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për dhënie të kontratës.

Versioni i plotë i Njoftimit për Kontratë është në dispozicion në: www.pppkosova.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Dr. Shahadije Xhemaili, me numër personal: 1015408100, e lindur me 02.05.1961 në Ferizaj, shpall të pavlefshme Licencën e Punës me numër: KO-02633-02-39, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë – Bordi Qendror për Rexhistrim dhe Licencim.

► Gjon Pjetraj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të Sh.F.M.U. "Fan Noli" në Dujakë KK Gjakovë.

► Shefki Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I.I.II,IV dhe diplomën e Sh.M.T. "Nexhmedin Nixha" – Elektroinstalues, Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

